



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK**

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë  
Bachelor në “Teknika Laboratorike Dentare”  
Universiteti “Aldent”**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**


1. Dr. Manola Kelmendi
2. Dr. Rozela Xhemnica (Rroço)

Shkurt/ 2022

## **TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**


**Për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në “Teknika Laboratorik Dentare”**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti Aldent
2	Njësia bazë që e ofron:	Fakulteti i Shkencave Dentare
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Teknika Laboratorike Dentare”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr.673, datë 27.09.2006
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	UMAS Nr. 478, datë 16.12.2015
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër 427, dt 22.08.2016
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	UMAS Nr. 102, datë 08.03.2016
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli i 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	16 PAE/ 5 PAK
18	Numri i studentëve (3 vitet e fundit):	139 studentë
19	Komente / të tjera:	-




## **TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Programi i studimit Bachelor në "Teknika Laboratorike Dentare" është hapur me VKM Nr.673, datë 27.09.2006 me formë studimi me kohë të plotë, 180 kredite dhe kohëzgjatje 3 vite akademike me emërtimin "Laborant Dentar". Me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 478, datë 16.12.2015 ky program riorganizohet me emërtimin "Teknika Laboratorike Dentare". Programi ka kaluar më parë proces akreditimi periodik, akredituar me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 102, datë 08.03.2016 (mbështetur në VKA Nr. 125, datë 18.02.2016.) Programi i studimit "Teknika Laboratorike Dentare" ofrohet nga Departamenti Laborant Dentar, Fakulteti i Shkencave Dentare. Në shqyrtim të aktivitetit të zhvilluar vitet e fundit, GVJkonstaton që programi i studimit Bachelor në "Teknika Laboratorike Dentare" ka rezultate konkrete në cilësinë e përgatitjes së studentëve duke ju ofruar atyre mundësi arsimimi që të ndërtojnë karrierën e tyre profesionale në sektorin privat, duke i pajisur me një gamë të gjerë njohurish teorike dhe praktike në fushën e laboratorit dentar duke qënë të aftë për tregun e punës. Universiteti "Aldent" ka vënë në dispozicion për këtë program studiminjës infrastrukturë mësimore bashkëkohore, ka kompletuar stafin mjekësor pedagogjik dhe administrativ sipas kërkesave të ligjit për arsimin e lartë dhe kapërmirësuar në mënyrë bindëse edhe bazën materiale e teknike në funksion të qëllimit e misionit të tij që lidhet me përgatitjen e kuadrove të lartë të fushës së mjekësisë. Këtij qëllimi i shërben edhe kërkesa e paraqitur për akreditimin e programit Bachelor në "Teknika Laboratorike Dentare".



## SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Programi i studimit Bachelor në "Teknika Laboratorike Dentare" plotëson të gjitha standardet e cilësisë dhe nuk kishte rekomandime të lëna nga akreditimi i mëparshëm.



## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;**

Grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) është ngritur nga ASCAL mbështetur në kërkesën e Institucionit për riakreditimin e programit të studimit Bachelor në "Teknika Laboratorike Dentare". Në përbërje të këtij grupi janë përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm Dr. Manola Kelmendi dhe Dr. Rozela Xhemnica (Rroço). Gjatë gjithë procedurës, ekspertët e jashtëm të vlerësimit janë asistuar nga specialistja e ASCAL, Znj. Aviola Bardhi.


Nga ana e Universitetit Aldent ishin marrë të gjitha masat për realizimin e vizitës në institucion në përputhje me axhendën. Vizita u realizua me datën 2-3 Dhjetor 2021. Gjatë vizitës, GVJ zhvilloi takime me Dekanin e Fakultetit të Shkencave Dentare, Përgjegjës të Departamentit që ofron programin e studimit Bachelor në "Teknika Laboratorike Dentare", grupin e vetvlerësimit, stafin akademik, studentët, njësinë bazë të sigurimit të cilësisë, përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore, Zyrës së Planifikimit të Karrierës, sekretarisë mësimore. GVJ vizitoi dhe mjediset mësimore, laboratorike ku zhvillohet programi i studimeve Bachelor në "Teknika Laboratorike Dentare", gjithashtu GVJ vizitoi edhe ambjentet e kampusit të ri universitar ku dhe zhvilloi takimet e ditës së parë sipas axhendës.

Në kuadër të hartimit të raportit ekspertët e jashtëm kanë shfrytëzuar Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB), dokumentacionin e brendshëm të Universitetit "Aldent" dhe vizitën në institucion. Mbështetur në dokumentacionin bazë të sistemuar në dosjen e vetvlerësimit, informacionet e marra, plotësimet, saktësimet si dhe gjetjet konkrete. GVJ formatoi gjithë bazën e nevojshme dhe të domosdoshme të të dhënave për të hartuar raportin e vlerësimit të jashtëm (RVJ).

Më datë 26/01/2022, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 56 Prot., datë 26/01/2022, dërgohet në Institucion Draft- Raporti i vlerësimit të jashtëm. IAL përcolli komentet, përmes AMS, më datë 31/01/2022 dhe me shkresë zyrtare Nr. 07 Prot., datë 31/01/2022.

### **GVJ pasi u njoh me komentet e Institucionit mbi Draft- Raportin, sqaron si vijon:**


**Komenti i Institucionit:** Në lidhje me standardin II, Kriteri 6, kemi paraqitur një tabelë ku ndarja është paraqitur gabimisht me gjashtë kategori, ndërkohë që tabela jonë aktuale është Konform ligjit në fuqi me pesë kategori (A-E) (bashkëngjitur tabela)



### **Komenti i GVJ:**

Grupi i vlerësimit të jashtëm mori në konsideratë komentin e institucionit lidhur me Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. U rishikua Standarti II.1, posaçërisht Kriteri 5 dhe 6 dhe u ndryshua komenti ynë mbi ndarjen e lëndëve në pesë kategori, pasi në tabelën e re të paraqitur nga IAL bashkëngjitur në shkresën përcjellse me nr. protokoli 07, datë 31.01.2022, përqindja e gruplëndëve sipas kategorive nga A-E është në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi VKM 879, datë 18.12.2019.

Për këtë arsye, ndryshuam edhe vlerësimin final duke përmbushur plotësisht të gjitha standartet, përfshirë dhe fushën II.



**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Teknika Laboratorike Dentare”**

**I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR**

<b>Standardi I.1</b>			
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>			
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>		
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit Bachelor në Teknika Laboratorike Dentare mbështetet dhe mbron vlerat kombëtare. <i>(Statuti i UAL)</i>		
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit që ofron Universiteti Aldent ruan vlerat akademike dhe kulturore kombëtare dukesynuaedhe zhvillimin dhe promovimin e mëtejshëm të tyre. Programet e studimit të ofruara nga UAL synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave kulturore kombëtare siç janë gjuha, historia, simbolet kombëtare, traditat dhe të përgatisë profesionistë të ardhshëm që do t'i lartësojnë këto vlera me dijen dhe moralin e tyre. <i>(Statuti i UAL)</i>		
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Fusha e studimit të programit Teknika Laboratorike Dentare përputhet me fushën e veprimtarisë së departamentit Laborant Dentar dhe ky program studimi është hartuar në përputhje me qëllimin dhe misionin e institucionit. <i>(Strategjia e zhvillimit UAL 2016-2021)</i>		
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Kurrikulae programit të studimit Bsc në Teknika Laboratorike Dentare është hartuar në funksion të nxjerrjes së një produkti sa më cilësor, në formimin e shprehive profesionale të studentët e këtij programi duke nxitur zhvillimin ekonomik kudo ku studenti angazhohet. <i>(Strategjia e UAL)</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>
			<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi I.2</b>	
<b>Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Mbështetur në raportin e vlerësimit të brendshëm ku thuhet se Univeristeti Aldent synontë përgatisë profesionistë me vlera etike dhe me ambicie për zhvillim profesional dhe kërkim shkencor si dhe gjetjeve gjatë vizitës në institucion. GVJ konstaton që programi i studimit Bachelor në "Teknika Laboratorike Dentare" është në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillimin e institucionit.

	<i>(Strategjia e zhvillimit UAL 2016-2021)</i>			
<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Programi i studimit Bachelor në "Teknika Laboratorike Dentare" hartohet dhe ofrohet në përputhje me statutin dhe rregulloren e Universitetit. Zbatimi i përcaktimeve statutore dhe rregullore se institucionit konstatohet edhe në standartizmin e mënyrës së hartimit të dokumentacionit si të njësisë kryesore ashtu edhe të njësisë bazë.  <i>(Rregullorja e UAL, Statuti UAL)</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Programi i studimit Bachelor në "Teknika Laboratorike Dentare", është hapur me VKM Nr.673, datë 27.09.2006 me një kohëzgjatje normale prej tre vitesh studimi akademike (180 ECTS). Programi i studimit Bachelor në "Teknika Laboratorike Dentare", ofrohet nga Departamenti Laborant Dentar si njësi bazë dhe Fakulteti i Shkencave Dentare si njësi kryesore, është në përputhje me fushat studimore që ky departament mbulon. <i>(Rregullore UAL, Rregullore FSHD)</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi I.3

**Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.	GVJ referuar gjatë vizitës në institucion dhe RVB-së konstaton që programi i studimit Bachelor në "Teknika Laboratorike Dentare" ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin profesional të studentëve. Në këtë program studimi ka një ndërthurje midis njohurive teorike, laboratorike dhe aftësimi praktik të studentit duke formuar koncepte të qarta për efikasitetin e punës në grup, duke njohur konkurrencën në tregun e punës dhe duke i ndërgjegjësuar për rëndësinë dhe dobinë e produkteve të tyre. Në Rregulloren e programit të studimit Bachelor në "Teknika Laboratorike Dentare", jepen objektivat e përgjithshme dhe ato specifike për formimin e studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale <i>(Syllabuset. Objektivat e programit të studimit)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë	Studimi i tregut të punës është bërë në mënyrë periodike nga IAL. Sipas dokumentacionit të ofruar rezultojnë se studimi i fundit i tregut të punës ka pasur si qëllim të grumbullojë të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar. Përveç komunikimit të formalizuar në dokumenta për interesin reciprok, në këtë zyrë disponoheshin edhe informacionet që merrnin studentet gjatë



<p>periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>zhvillimit të praktikave në laboratore si dhe orientimi i stafit akademik dentar për të sugjeruar për mundësi punësimi. Institucioni falë bashkëpunimit që ka me institucionet shëndetësore në vend, merr vazhdimisht informacione mbi nevojat dhe tregun e punës. Referuar statistikave të diplomuarve, emigrimit të tyre drejt tregut ndërkombëtar, rezulton se ka kërkesë të lartë për këtë drejtim profesionistësh. (Studim tregu Ba në TLD/ Takimet në IAL)</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe të dhënat në raportin e vlerësimit të brendshëm rezulton se objektivat formuese, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit “Bachelor në Teknika Laboratorike Dentare” përmbushin pritshmëritë në fushën e të nxënit si dhe garantojnë përfundimin e dijeve. Në përfundim të këtij programi, studentët fitojnë aftësitë dhe kompetencat sipas nevojave të tregut dhe janë në gjendje të realizojnë individualisht punime protetike laboratorike. (Plani mësimor Ba në TLD); (Syllabuset)</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p>X</p>


<p><b>Standardi I.4</b> <b>Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>GVJ mbështetur në dokumentacion dhe në vizitën në IAL konstaton që Universiteti Aldent i ka burimet, kapacitetet dhe përvojën e duhur për të ofruar programin e studimit Bachelor në “Teknika Laboratorike Dentare”. Programi i studimit ofrohet nga Departamenti Laborant Dentar i Fakultetit të Shkencave Dentare i cili ka infrastrukturën e nevojshme për realizimin e këtij programi studim. Sipas evidencës (Tabelat RVB Ba në TLD, tabela nr.2), personeli akademik efektiv (PAE) mbulon rreth <b>93% të ngarkesës akademike në auditor.</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas</p>	<p>Nga verifikimi mund të themi se programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore . UAL është i orientuar tërësisht në ofrimin e programeve të studimit në fushën e mjekësisë. Bazuar në Statutin e institucionit, Rregulloret e universitetit, Strategjinë e zhvillimit dhe programet qëçdo fakultet ofron, fusha e përgjithshme dhe specifike e programeve të studimit është në përputhje me fushën kryesore të</p>

direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	UAL. Programi i studimit Bachelor në “Teknika Laboratorike Dentare”, është në të njëjtin profil që ka njësia kryesore. (Statuti i UAL); (Rregullore e Universitetit ALDENT); (Rregullore e Fakultetit të Shkencave Dentare); (Rregullore e programit të studimit TLD);			
<b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Departamenti Laborant Dentar përgjegjës për këtë program studimi, ka kapacitetet akademike dhe logjistike për realizimin me sukses të programit mësimor. Programi i Studimit është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të Fakultetit të Shkencave Dentare sipas klasifikimit/ kodifikimit të programit referuar direktivave kombëtare dhe europiane. (Rregullore e Universitetit ALDENT); (Rregullore e Fakultetit të Shkencave Dentare);			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b> X

#### Standardi I.5



**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Nga vizita në Institucion si dhe nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se strukturat administrative dhe akademike të institucionit bashkëpunojnë me njëra tjetrën në kuadër të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor dhe ky bashkëpunim është i qëndrueshëm dhe efikas. GVJ konstaton që Universiteti "Aldent" ka marrëdhënie të mbështetura në akte ligjore e nënligjore me të gjitha njësitë kryesore e ato bazë brenda institucionit duke siguruar një bashkëpunim funksionues. Bashkëpunimi është i njehsueshëm në aktivitetet e promovimit të institucionit, në koordinimin e trajnimeve, objektivat për rritjen e cilësisë së botimeve shkencore si dhe në përdorimin e ambienteve të përbashkëta. (Takimet në UAL)
<b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos	Universiteti Aldent ka nënshkruar një sërë marrëveshje në funksion të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Këto marrëveshje bëhen në kuadër të zhvillimit të praktikave mësimore, për efekte të kërkimit shkencor si dhe për të ndihmuar studentët në gjetjen e një vendi pune.



marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.	GVJ përveç gjetjeve në RVB lidhur me bashkëpunimin e insitucionit me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe të huaj, u informua konkretisht edhe gjatë takimit me përfaqësuesit e zyrës së Projekteve e Marrdhënieve Ndërkombëtare. Konkretisht insitucioni kishte realizuar një intership në Poloni dy javor për edukimin në vazhdim të stafit akademik. Referuar dokumentit <i>(Tabelat RVB Ba në TLD. Tabela nr. 4)</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Departamenti harton në mënyrë periodike raportin analitik në lidhje me përfitimet e marrëveshjeve kontraktuale. Këto raporte janë evidentuar edhe gjatë vizitës në institucion.  <i>(Tabelat RVB Ba në TLD Tabela nr. 18) (Raporti periodik nga marrëveshjet e bashkëpunimit)</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	Nga verifikimi i dosjes dhe vizitës në institucion rezulton se Departamenti që mbulon programin mësimor Teknika Laboratorike Dentare ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit , bashkëpunon me kompani të ndryshme me qëllim zhvillimin dhe mbikëqyrjen e praktikave mësimore të programit të studimit. Duhet theksuar se institucioni ofron infrastrukturën e nevojshme për të mbuluar të gjitha praktikat mësimore që përmban plani mësimor i këtij programi studimi. <i>(Marrëveshjet e bashkëpunimit)</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Departamenti referon vështirësi në organizimin e plotë të disa trajnimeve të përvitshme në kuadër të bashkëpunimeve në periudhën e pandemisë Covid 19, por UAL ka eksperiencën e duhur dhe bashkëpunimet e nevojshme për të ofruar mbështetje të vazhdueshme për studentët e diplomuar ku nëpërmjet tyre mbështet trajnimin profesional të mëtejshëm të studentëve.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht <b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht <b>X</b>
---------------------------------------------------------	----------------	-----------------------	----------------------	-----------------------------------

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit Bachelor në Teknika Laboratorike Dentare është i strukturuar në 3 vite akademike, organizuar në 6 semestra me 180 ECTS. Ky program është i organizuar në module dhe është i vlerësuar në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Sasia e krediteve të grumbulluara gjatë një viti, nga një student që ndjek këtë program studimi është 60 kredite. Zhvillohen gjithsej 21 lëndë me 34 modulet përkatëse të ndara sipas 3 viteve akademike. Detyrimi përmbyllës për marrjen e diplomës shlyhet në trajtën e provimit të formimit (teorik dhe praktik). <i>(Plani mësimor Ba.TLD); (Rregullore e programit të studimit TLD)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të programit të studimit Bachelor në Teknika Laboratorike Dentare si dhe gjatë takimit me personelin akademik dhe studentët, u konstatua se ky program studimi u ofron studentëve njohuri, të cilat do të jenë të nevojshme dhe ju përgjigjen kërkesave për realizimin e tyre profesional edhe për të ndjekur ciklet e tjera të studimit. <i>(Plani mësimor Ba në TLD; (Syllabuset Ba.TLD)</i>
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparura në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	Lëndët e parashikuara që zhvillohen në programin e studimit Bachelor në Teknika Laboratorike Dentare janë gjithëpërfshirëse duke filluar nga ato të formimit të përgjithshëm si shkencat e sakta, gjuhë të huaj apo anatomi dhe më pas duke u thelluar përgjatë viteve në lëndë profesionale si protezë totale, proteze parciale dhe fikse, ortodonti etj, të cilat synojnë të japin njohuritë e mjaftueshme teorike dhe praktike. <i>(Plani mësimor Ba në TLD); (Tabelat RVB Ba në TLD, tabela nr.9 )</i>
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Programi i studimit Bachelor në "Teknika Laboratorike Dentare" ofron kompetencat e duhura në fushën e dentistrisë. Studenti pajiset me njohuritë e nevojshme teorike dhe praktike për zhvillimin profesional të tij.  <i>(Plani mësimor Ba në TLD)</i> <i>(Syllabuset e lëndëve në Ba në TLD)</i>

<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>GVJ vlerëson se programi i studimit Bachelor në Teknika Laboratorike Dentare përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e programit të cilat janë në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave VKM nr.879, datë 18.12.2019.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Lëndët janë ndarë në gjashte kategori (A, B, C, D, E). Bazuar në kreditet përkatëse lëndët e kategorive të ndryshme kanë këtë shpërndarje:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• kategoria A – 18.34%</li> <li>• kategoria B – 54.45%</li> <li>• kategoria C – 13.33%</li> <li>• kategoria D – 9.44%</li> <li>• kategoria E – 4.44 %</li> </ul> <p>Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 879, datë 18.12.2019) ndarja e lëndëve është nga A në E, ndarja e planit të tyre është në përputhje me këtë VKM. (Plani mësimor sipas veprimtarive, tab komente mbi draftin)</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi II.2</b></p>	
<p><b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Departamenti Laborat Dentar është pjesë e Fakultetit të Shkencave Dentare. Fakultet për vitin akademik 2020-2021 ka gjithsej <b>50 pedagogë</b>, nga të cilët <b>33 janë pedagogë efektiv (PAE)</b> nga ku: 3 kanë titullin "Profesor", 2 kanë titullin "Profesorë të Asociuar", 6 kanë gradën Dr, 5 janë Spa, 3 janë Dr në proces, 6 me Msc, 6 me Mp, 2 Ba dhe <b>17 pedagogë me kontratë (PAK)</b> nga ku 2 kanë titullin "Profesor", 5 kanë titullin "Profesorë të Asociuar", 3 kanë gradën Dr. 4 Spa dhe 3 me Msc.</p> <p>Ndërsa Departamenti Laborant Dentar ka <b>14 pedagogë gjithsej</b>, nga të cilët <b>10 PAE dhe 4 PAK.</b></p> <p>Fakulteti i Shkencave Dentare dhe Departamenti Laborant Dentar përmbushin plotësisht të gjitha detyrimet ligjore që lindin nga ky proces në funksion të arsimit cilësor. (Tabelat RVB Ba në TLD, tabela nr.2)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një</p>	<p>Përgjegjës për programin e studimit Bachelor në "Teknika Laboratorike Dentare" është përgjegjësi i Departamentit me gradë shkencore "Doktor". GVJ konfirmoi se programi i studimit ka një</p>

<p>person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>kordinator i cili siguron mbarëvajtjen e programit mësimor. Koordinator didaktik (përgjegjësi i programit) është paracaktuar të bëjë veprimtari që kërkojnë aftësi bashkëpunuese dhe komunikuese për të menaxhuar lidhjet midis subjekteve të brendshme dhe të jashtme të përfshirë në procesin mësimor. Koordinator i programit informon vazhdimisht përgjegjësin e programit merret me evidentimin e problemeve të studentëve në të tre vitet e studimit akademik, koordinon punën për krijimin e formateve të syllabuseve, oraret mësimore si dhe vë në dijeni stafin pedagogjik në lidhje me to. Gjithashtu reflekton shqetësimet e ngritura nga stafi akademik në lidhje me përmirësimin e syllabuseve apo planit studimor. Ai shërben si urë lidhëse mes përgjegjësit të departamentit dhe stafit akademik si dhe studentëve. <i>(Vendim dekanati për koordinatorët).</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Bazuar në verifikimin e dokumentacionit rezultojnë se njësia bazë përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin e strukturës akademike. Fakulteti i Shkencave Dentare ka në përbërje:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Departamentin e Stomatologjisë;</li> <li>- Departamentin Laborant Dentar;</li> <li>- Qendrën eshërbimit dhe formimit klinik.</li> </ul> <p>Departamenti Laborant Dentar përgjegjës për programin e studimit Bachelor në "Teknika Laboratorike Dentare", plotëson kriteret e përcaktuara në Ligjin për "Arsirin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë". <i>(Tabelat RVB BanëTLD, tabela nr. 1)(Statuti i UAL)</i> <i>(Rregullore UAL, Rregullore FSHD, Rregullore departamenti)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Personeli akademik efektiv (PAE) mbulon rreth 93% të ngarkesës akademike në auditor. Stafi akademik sipas departamenteve për vitin akademik 2020-2021: Departamenti Laborant Dentar: -10 PAE, ndër të cilët 4 me tituj / grada; -4 PAK, ndër të cilët, 1 me tituj / grada;</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Departamenti i Stomatologjisë: -13 PAE, ndër të cilët 5 me tituj / grada; -6 PAK, ndër të cilët 5 me tituj / grada;  Qendra e Formimit dhe Shërbimit Klinik: -10 PAE, ndër të cilët 4 me tituj / grada; -7 PAK, ndër të cilët 4 me tituj / grada;</p>

	<p>Departamenti Laborant Dentar që është përgjegjës për programin e studimit për tre vitet akademike në raportet PAE/ PAK është si më poshtë:</p> <p>Për vitin akademik 2018-2019, (10 PAE / 2 PAK), nga këta me grada/tituj shkencore 2 / 1;</p> <p>Për vitin akademik 2019-2020, (12PAE / 4 PAK), nga këta me grada/tituj shkencore 2 / 1;</p> <p>Për vitin akademik 2020-2021, (10 PAE / 4 PAK) nga këta me grada/tituj shkencore 2 / 1;</p> <p>Personeli akademik i programit të studimit në vitin akademik 2020-2021 përbëhet nga personel akademik me grada dhe tituj nga Msc deri në Prof. Një kontribut të rëndësishëm në realizimin e programit të studimit jep personeli ndihmës akademik (5 individë të angazhuar) të cilët angazhohen në realizimin e praktikave laboratorike dhe profesionale.</p> <p><i>(Tabelat RVB Ba në TLD. tabela nr.2;5.3)</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi II.3

**Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ mbështetur në dosjen e vetvlerësimit dhe vizitës në institucion konstaton së Departamenti Laborant Dentar dhe FSHD disponojnë të gjitha informacionet e nevojshme përorganizimin, strukturën dhe përmbajtjen e këtij programi studimi, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Si pjesë të këtij informacioni përmendim që nga plani strategjik i programit të studimit , statuti i universitetit, rregulloret e universitetit. Informacionet janë të publikuara edhe në faqen e internetit të Universitetit dhe të aksesueshme nga të gjithë.</p> <p><i>(Plani mësimor, Rregullorja e programit; Syllabuset e lëndëve; CV e personelit)</i></p>


<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Programi i studimit "Teknika Laboratorike Dentare" është organizuar me 6 semestra dhe zgjat 3 vite akademike.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në "Teknika Laboratorike Dentare" është organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi është i ndarë në lëndë mësimore, module, praktike dhe detyrime përmbyllëse. Çdo lëndë ndahet në aktivitete formuese si: Leksione/ Seminare (ushtrime)/ laboratorë/ detyra (projekte)/ praktika. Nga shqyrtimi i planit mësimor, konstatohet se disiplinat mësimore dhe komponentët e tjerë mësimor janë të organizuara në kategori: A, B, C, D, E.</p> <p><i>(Plani mësimor, Tabelat RVB, Tabela komente mbi draftin)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Në planin mësimor të programit të studimit përfshihet ngarkesa mësimore, orët në auditor/ jashtë auditorit. Në rregulloren e programit si dhe në syllabuset e lëndëve, paraqitet informacion i hollësishëm për frekuentimin/ ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve, etj. Vlerësimi i dijeve është gjithë- semestral dhe realizohet nëpërmjet formave të vlerësimit tradicionale dhe alternative. Mënyra e vlerësimit të lëndës varion duke u bazuar në ngarkesën në kredite të lëndës/modulit. Frekuentimi i leksioneve dhe seminareve është i detyrueshëm deri në masën 75%. Frekuentimi i detyrave të kursit, mësimi praktik është i detyrueshëm në masën 100%. Projektet dhe detyra e kursit janë të detyrueshme të shlyhen në masën 100%.</p> <p><i>(Plani mësimor) (Syllabuset e lëndëve) (Tabelat RVB Ba në TLD, tabela nr.13)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Në Rregulloren e programit të studimit Bachelor në "Teknika Laboratorike Dentare" jepet informacioni i nevojshëm në lidhje me kriteret specifike të pranimit, transferimit të studimeve dhe ekuivalentimit të studimeve. Të gjithë kandidatët që dëshirojnë të rregjistrohen në programin e studimit Bachelor në "Teknika Laboratorike Dentare" duhet të plotësojnë përkatësisht kriteret e pranimit, të ndjekin procedurat e regjistrimit dhe plotësojnë dokumentacionin. UAL ofron mundësi për transferime të studentëve në vite të ndërmjetme midis programeve të të njëjtit cikël, brenda vetë institucionit apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë, si dhe për transferime nga programet e mëparshme në programe tëstudimeve të ciklit të parë.</p> <p><i>(Vendim senati për kriteret e pranimit të studentëve)</i> <i>(Procedura e transferimit të studenteve UA)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar dhe më konkretisht nga dosja e syllabuseve, GVJ konstatoi se nëpërgjithësi syllabuset</p>



nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	e çdo lënde të programit të studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. Çdo syllabus ndërtohet bazuar në një format të gjithëpranuar ku pasqyrohet ngarkesa brenda dhe jashtë auditorit, kreditet ECTS, përshkrimin e lëndës, objektivat e lëndës, temat për secilën javë, literaturë kryesore dhe mbështetëse, rezultatet e të nxënësve të lëndës, kontributi i lëndës në kompetencat e programit të studimit, metodat e vlerësimit të njohurive. (Syllabuset e lëndëve)			
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	GVJ konstatoi nga të dhënat në RVB dhe takimeve në institucion se në fillim të çdo viti akademik, Departamenti Laborant Dentar rishikon përmbajtjen e syllabuseve si dhe literaturën dhe këto syllabuse dorëzohen sipas formateve të aprovuara dhe të miratura në Senatën akademik dhe arkivohen në departament.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi II.4</b>	
<b>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënësve dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Ngarkesa e programit të studimit është në përputhje me aktet ligjore dhe është treguar në mënyrë të detajuar në programet e lëndëve. Shpërndarja e ngarkesës së punës është bërë në përputhje me ECTS përkatëse dhe respekton parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi. (Plani mësimor) ; (Syllabuset)
<b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.	Përmbajtja e përgjithshme e moduleve dhe transmetimi i njohurive lehtësojnë formimin teorik dhe praktik të studentëve në funksion të punësimit të tyre. Shpërndarja e lëndëve gjatë tre viteve akademike duke filluar në vitin e parë me lëndë të formimit të përgjithshëm e duke u thelluar në vitin e dytë dhe të tretë në lëndët praktike profesionale i mundëson studentitë aftësohet profesionalisht për tregun e punës. (Plani mësimor Ba në TLD)
<b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e	Në vitin e parë bëhen kryesisht lëndë të formimit bazë si anatomi dhe fiziologji, mikrobiologji. Në vitin e dytë dhe të tretë merren njohuri të lidhura ngushtësisht me fushën e studimit. Programi ofron mundësi të shumta informacioni si dhe nocione bazë dhe të thelluara

objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional.	profesionale. Disiplinat në planin mësimor, sasia e krediteve dhe e orëve të vëna në dispozicion për secilën disiplinë, syllabuset e tyre, bën të mundur që në përfundim të programit të studimit të jenë arritur objektivat formuese të këtij program studimi dhe rezultatet e të nxënit dhe aftësimit profesional. <i>(Plani mësimor Ba nëTLD) (Syllabuset e lëndëve )</i>
<b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Struktura e programit është krijuar duke u bazuar në përvojën e stafit, brenda dhe jashtë vendit dhe është e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori – praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor. <i>(Programi i studimit BA në Teknika Laboratorike Dentare )</i>
<b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Nga analiza e kryer në lidhje me ndarjen e krediteve sipas aktiviteteve formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik, rezultojnë se programi paraqet një shpërndarje të qartë të ngarkesës teorike dhe praktike për t'i mundësuar studentit procesin e mësimnxënies praktike transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. Karakteri i programit të studimit ka në fokus praktikat laboratorike të cilat zhvillohen në masën 100 % në ambjentet e njësisë përgjegjëse. <i>(Programi i studimit BA në TLD) ; (Marrëveshjet e bashkëpunimit për praktikat profesionale)</i>
<b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	<b><i>Literatura në gjuhën shqipe e këtij programi paraqet pengesë mbështetur në mungesën e teksteve në gjuhën shqipe.</i></b> Kjo është plotësuar me ciklet e leksioneve të shkruara të hartuara nga pedagogët përgjegjës të lëndëve. Këto materiale hidheshin rregullisht dhe në platformën online UAL- LMS të Universitetit. Syllabuset e lëndëve përditësohen në mënyrë të vazhduar <b><i>por jo detyrimisht me literaturë të 5 viteve të fundit.</i></b> <i>(Syllabuset e lëndëve ); (Lista e literaturës në bibliotekë)</i>

<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p> <p><b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Teknika Laboratorike Dentare” garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave në fushën e dentistrisë. Niveli i njohurive është në përputhje edhe me nivelin e ciklit të parë të studimeve, duke krijuar bazat e duhura për një studim më të thelluar dhe të përparuar në ciklin e dytë, master profesional. Ngarkesa e lartë e praktikave laboratorike të paraqitura në planin mësimor të këtij programi studimi mundëson aftësimin profesional të studentëve në përgatitjen e punimeve laboratorike. Programi është në përputhje me kërkesat dhe pritshmëritë e tregut të punës.</p> <p><i>(Plani mësimor)</i> <i>(Syllabuset e lëndëve)</i></p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Si rezultat i këtij bashkëpunimi UAL ka marrë informacion në lidhje me kërkesat e tregut të punës. UAL është përpjekur të implementojë propozimet e tyre për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës. Departamenti Laborant Dentar është vazhdimisht në marrëdhënie me partnerët shëndetësor dhe tregun në përgjithësi, me qëllim evidentimin në programet e lëndëve të nevojave dhe kërkesave të tregut.</p> <p><i>(Takimet e realizuara në UAL)</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p>X</p>

#### Standardi II.5

**Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.**


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për</p>	<p>Referuar dokumentit (Tabelat RVB Banë TLD, tabelat nr.5) të dhënat për stafin e angazhuar në mësimdhënie për këtë program studimi.</p> <p>Përsa i përket stafit akademik për programin e studimit në këtë vit akademik, sipas evidencës (Tabelat RVB Ba në TLD, tabela nr. 5.3), rezultojnë të jenë angazhuar në mësimdhënie <b>21 pedagogë gjithsej, ku 16 PAE</b>, nga të cilët 2 me gradën Dr, 3 me SPA, 1 me Dr në proces si edhe 4 asistentë- lektorë me Mp, 1 asistentë-lektorë me Mp, 5 me Msc dhe <b>5 PAK</b> nga të cilët 2 Prof. Asoc, 1 me SPA si edhe 2 me Msc.</p> <p>Referuar dokumentit (Tabelat RVB Banë TLD, tabelat nr.11) <b>programi i studimit në vitin akademik 2020-2021 ka 2041 orë</b></p>



<p>drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p><b>mësimore nga të cilat 1984 orë mbulohe nga PAE pra rreth 93% dhe stafi akademik PAK mbulon 7%, duke plotësuar kështu kriterin për ngarkesën mësimore mbi 70%.</b></p> <p>GVJ pas shqyrtimit të CV-vetë stafit akademik të angazhuar në programin e studimit të vënë në dispozicion në RVB si dhe takimit me stafin akademik, konstatuan se personeli akademik me kohë të plotë dhe më kohë të pjesshme i angazhuar në programin e studimit Bachelor në "Teknika Laboratorike Dentare" kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik.</p> <p><i>(CV e personelit akademik); ( Tabelat RVB Bane TLD, tabela 11)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se në përgjithësi personeli akademik që mbulon programin e studimit Bachelor në "Teknika Laboratorike Dentare" ka nivelin e duhur të kualifikimit në fushën akademike dhe kërkimore për këtë program studimi dhe për lëndët që stafi akademik mbulon. Stafi akademik është i specializuar në disiplina të ndryshme të dentistrisë dhe laboratorit dentar.</p> <p><i>(CV e personelit akademik)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe verifikimi i dokumentacionit rezultoi se praktika mësimore kryhet pranë UAL-së. Gjithashtu, në kuadër të marrëveshjeve për praktikën laboratorike profesionale, parashikohet përcaktimi nga ana e institucionit i një udhëheqësi të praktikës, i cili të kontrollojë dhe të informojë mbi mbarëvajtjen e saj.</p> <p>Karakteristikë specifike profesionale të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Teknika Laboratorike Dentare, ka orientuar modalitetet e diplomimit, përmes kombinimit të përgatitjes praktike të një punimi laboratorik protetik, ose ortodontik, dhe provimit të formimit teorik mbi lëndët profesionale të programit të studimit.</p> <p>Punimi praktik laboratorik i diplomës realizohet me mbarimin e sesionit të fundit të provimeve semestrale.</p> <p><i>(Marrëveshjet e bashkëpunimit)</i> <i>(Rregullore diplomimit)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Universiteti Aldent zhvillon mësimin në disa lëndë specifike kryesisht ato të formimit të përgjithshëm, duke shfrytëzuar ambjentet e kabineteve që institucioni disponon si auditorin e anatomisë, të IT, etj. Stafi ndihmës mësimor është i angazhuar plotësisht në ndihmë të realizimit të orëve laboratorike por edhe për mirëmbajtjen e kabienteve apo mjediseve mësimore.</p> <p><i>(Takimet në UAL)</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Universiteti organizon në mënyrë periodike aktivitete trajnimi në fushën e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Këto aktivitete synojnë zhvillimin e stafit në përdorimin e metodave të ndryshme innovative në fushën e mësimdhënies, të përshtatura sipas natyrës së programeve të studimit. Këto udhëzues dhe aktivitete janë të publikuara në faqen zyrtare të internetit. Referuar RVB-së, universiteti për shkak të specifikës së situatës së pademisë Covid-19 ku është zhvilluar pjesa më e madhe e studimit në këtë program, ka adaptuar përdorimin e metodologjisë online të mësimdhënies. UAL ka hartuar dhe materialin udhëzues për metodat e mësimdhënies në distancë (online). <i>(Rregullore UA L- LMS), (Rregullore e provimeve online)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë është përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin në mënyrë periodike të mësimdhënies. Kjo njësi monitoron në vazhdimësi plotësimin e standardeve të cilësisë në mësimdhënie nga stafi akademik dhe ai ndihmës akademik, përmes vlerësimeve vjetore të studentëve dhe raporteve vjetore të vetë pedagogëve. Në fund të çdo semestri dhe viti akademik analizohet puna e të gjithë anëtarëve të stafit dhe bëhen raportimet përkatëse duke raportuar indikatorët e përdorur në formularin e performancës së pedagogut. <i>(Rregullore e NjSBC); (Formulari i performancës)</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Nga vizita në institucion rezulton se studentët janë të përfshirë në vlerësimin periodik të stafit akademik. Në fund të semestrit studentët plotësojnë pyetësin e kontrollit të cilësisë, (vlerësimi të brendshëm). Paraqiten pyetje të shumta me qëllim vlerësimin e aspekteve të ndryshme në lidhje me lëndën dhe performancën e pedagogut. Nga ana tjetër studentët janë vazhdimisht në kontakt me koordinatorin e programit dhe pedagogët tutorë për paraqitjen e problematikave të tyre. Në fund bëhet raporti përfundimtar. GVJ konstatoi që institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve. <i>(Rregullore e NjSBC); (Pyetësi i studentëve)</i>
<b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Referuar formatit të pyetësit, pyetësi për vlerësimin e pedagogëve dhe të lëndëve është një nga elementet e rëndësishëm që përdoret për të monitoruar cilësinë e mësimdhënies. Pyetësi i studentëve izhillohet në vitin akademik 2020 - 2021, përmban një analizë të detajuar me gjetjet dhe konstatimet. NJSBC si struktura përgjegjëse


	analizon gjetjet dhe ia percjell Senatit Akademik. Pastaj NJSBC harton planin e aktiviteteve në përmbushje të kërkesave të studentëve. <i>(Rregullore e NJSBC), (Pyetësori i studentëve).</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.	Nga vizita në institucion rezulton se IAL ka si parim vlerësimin dhe promovimin e praktikave të mira në mësimdhënie duke promovuar shembuj të praktikave më të mira, nxitjen e vazhdimësisë së tyre, dhe përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies duke organizuar aktivitete të ndryshme trajnimi, leksione të hapura dhe seminare me profesorë të ftuar nga universitete të shquara. Nga ana tjetër, institucioni është i përfshirë në projekte të ndryshme ndërkombëtare, si dhe ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi me universitete ndërkombëtare, përmes të cilave motivon stafin të marrë pjesë në programet e mobilitetit të stafit. <i>(Pyetësori i studentëve)(Formulari i performances akademike)</i> <i>(Marrëveshjet e bashkëpunimit)</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi III.2

**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	GVJ konstaton se format e mësimdhënies përfshijnë leksionet, seminarët, ushtrimet, laboratorët, praktikat mësimore e profesionale, provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare, detyrat e kursit, projekte, etj. Departamenti organizon trajnime apo ëorkshope për të përmirësuar procesin e mësimdhënies. Platforma e edukimit në distancë UAL- e-learning ( <a href="https://ual.iqe.al/">https://ual.iqe.al/</a> ) është vënë në kuadër të mësimin online duke krijuar gjithashtu mundësi për prezantimin e veprimtarive laboratorike që zhvillohen në institucion gjatë periudhës së pandemisë COVID -19 ku nuk mund të realizoheshin dot praktikat laboratorike në auditor. <i>(Plani mësimor Ba në TLD); (Syllabuset)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e	Nga vizita në institucion është verifikuar se stafi pedagogjik i përgjigjet me seriozitet diversitetit dhe nevojave të studentëve. Pedagogët në përputhje me natyrën e programit ofrojnë metoda dhe mundësi alternative (shembuj realë, etj) në mënyrë që studenti të rrisë interesin dhe dëshirën e të nxënit. Kjo u konstatua nga GVJ gjatëtakimit me studentët, të cilët pohuan se pedagogët sjellin shembuj konkrete nga punimet e tyre klinike në pacientë në ndihmë të studentëve për ta bërë lëndën sa më të qartë dhe të kuptueshme për studentët. <i>(Takimi me studentët)</i>

aktiviteteve formuese në veçanti.	
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksibile pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.	Institucioni ka investuar në përmirësimin e metodave të mësimdhënies dhe kushteve të mësimdhënies. Departamenti ofron metoda pedagogjike shumë të larmishme dhe fleksibile përveç metodave të zakonshme të mësimdhënies siç janë leksionet dhe seminarat, studentët marrin pjesë në punën laboratorike, kryejnë detyra kursi dhe projekte, zhvillojnë prezantime etj.  <i>(Strategjia e zhvillimit të UAL)</i>
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	GVJ pas takimit me stafin akademik dhe me studentët e programit, konstaton se stafi është kompetent për njohuritë dhe konceptet që shpjegon. Personeli akademik angazhohet në mësimdhënie përmes një procesi dinamik të vlerësimit të njohurive, kompetencave dhe metodologjisë në mësimdhënie. Krahas tyre, stafi akademik angazhohet në nxitjen e studentëve në mësimnxënie përmes përdorimit të platformës së edukimit online (UAL-LMS). <i>(Takimi me stafi dhe drejtuesit) (Cv-të e stafit akademik)</i>
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	GVJ mbështetur në RVB dhe vizitën në institucion vlerëson se format dhe metodat e mësimdhënies janë në vlerësim të vazhdueshëm nga vetë stafi akademik dhe departamenti që mbulon programin e studimit Bachelor në “Teknika Laboratorike Dentare”. Vëmendje të veçantë ju kushtohet sugjerimeve që vinë nga vetë studentët, me qëllim rritjen e nivelit të mësimnxënies dhe përmirësimin e rezultateve përfundimtare të studentëve sidomos pas rezultateve të siguruar nga NJSBC. <i>(Takimi me stafi dhe koordinatorin e programit)</i>
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.	Stafi akademik në Departamentin Laborant Dentar përdor metoda pedagogjike interaktive, përveç metodave tradicionale të diskutimit, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit mësimdhënies, si leksionet, seminarat dhe labororet. Studentët realizojnë vetë punimetlaboratorike, dorëzojnë detyra dhe projekte, kryejnë prezantime të punimeve të tyre individuale. Studentët janë të lirë të bëjnë pyetje dhe komente gjatë orës së mësimit. <i>(Plani mësimor, Syllabuset) (Takimi me studentët)</i>
<b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e	Metodat e përdorura në mësimdhënie nxisin autonominë e studentit, i cili fillimisht punon nën mbikëqyrjen e pedagogut dhe më pas fillon të punojë në mënyrë graduale si i pavarur fillimisht duke vizatuar morfologjinë dentare, pastaj me skulptimin e çdo dhëmbi dhe në përfundim të studimeve çdo student është i aftë të realizojë çdo punim protetik laboratorik. Prezantimet e punimeve nga ana e studentëve, projektet, detyrat dhe punimet laboratorike, inkurajojnë ndjenjën e





marrëdhëniet e respektit të ndërsjellë mes tyre.	pavarësisë së studentit, punën në grup dhe të menduarit kritik. Nga biseda me personelin akademik u sollën shembuj të punimeve të kryera nga studentët, ku punimet më të mira vendosen në ekspozitor e punimeve në vite. (Plani mësimor, Syllabuset); (Takimi me studentët)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
<p><b>Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithëinfrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.</b></p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b>Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion si dhe nga informacioni i depozituar mbi planimetrinë e kampusit universitar, konstaton se procesi mësimor i programit të studimit, realizohet në hapësira të bashkëkohore, të mjaftueshme, cilësore, të pastra dhe që mirëmbahen rregullisht. Institucioni këtë vit akademik ka hapur edhe kampusin e tij të ri modern në ambientet e bollshme të të cili janë zhvilluar edhe aktivitet shkencore.(Planimetri Kampusi i ri)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Godina ku zhvillohet procesi mësimor është e pajisur me salla leksioni, salla seminari dhe laboratore të shumta për realizimin e punimeve laboratorike prototipe. Ambientet e mësipërme kanë logjistikën e nevojshme për mbarëvajtjen e procesit mësimor. Sallat e leksioneve dhe të seminareve janë të pajisura me video-projektorë, tabela, kompjuter, kanë ndriçimin e duhur, internet në të gjithë kampusin për të gjithë studentët dhe stafin, bibliotekën moderne etj. (Vëzhgimi i mjediseve)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Në të gjithë universitetin është i mundur aksesin në rrjetin kompjuterik të shkollës, sistemet e menaxhimit dhe sekretarisë mësimore. Universiteti i pajis studentët dhe stafin e tij me emaile me bazë Google. Po ashtu studentët kanë akses të palimituar në platformë mësim online LMS. Përveç menaxhimit të mësimdhënies, platforma e LMS shërben edhe për marrjen e shënimeve, njoftimeve të ndryshme. Studenti mund të përdori këtë platform për dorëzimin e projekteve apo detyrave të kursit. Shërbimi databazës së centralizuar është shtrirë edhe në shërbimin e sekretarisë mësimore që menaxhon në mënyrë të centralizuar databazën e studentëve, regjistrimet, provimet, notat e studentëve dhe çdo dokumentacion tjetër që lidhet me studentët. Edhe këtë sistem studentët mund ta aksesojnë online nëpërmjet internetit. Lidhur me infrastrukturën e brendshme, institucioni disponon salla</p>

	leksionesh seminaresh, të pajisura me kompjutera dhe projektorë, gjithashtu u jepet dhe akses në internet nëse është e nevojshme.
<b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.	UAL disponon aktualisht një databazë elektronike të përditësuar me literaturën kryesore e që përdoret nga stafi dhe studentët. Literatura është bashkëkohore dhe shtohet vazhdimisht duke u vënë në shërbim të studentëve në formën e leksioneve të shkruara, në poëer point dhe në formë libri. Materialet didaktike për mbarëvajtjen e procesit mësimor gjenden dhe bibliotekën e fakultetit. <i>(Lista e librave periodikëve shkencorë në bibliotekë)</i>
<b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	Referuar RVB-së, UAL ka vënë në dispozicion të bibliotekës një hapësirë të konsiderueshme dhe modern ku janë afishuar rreth 16 mijë botime universitare, periodikësh, studimesh etj. Biblioteka ka sistemin elektornik të menaxhimit të saj ku studentët dhe pedagogët mund të gjejnë në kohë reale botimet e nevojshme. Librat e bibliotekës janë inventarizuar dhe ndarë sipas fushave dhe temave. Literatura e bibliotekës gjendet kryesisht në gjuhën angleze. <b><i>Biblioteka zotëron pak tituj shqip në lidhje me programin e studimit Bachelor në Teknika Laboratorike Dentare.</i></b> Biblioteka e UAL qëndron e hapur gjatë gjithë ditës dhe në këtë mënyrë për qëllime studimi jo vetëm gjatë orarit mësimor por edhe pas përfundimit të tij për tu përdorur nga studentët dhe stafi. <i>(Lista e librave periodikëve shkencorë në bibliotekë)</i>
<b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Njëkohësisht studentët dhe stafi akademik kanë akses edhe në bibliotekën online “Hinari”, bibliotekë e Organizatës Botërore të Shëndetësisë, në të cilën Universiteti Aldent është i abonuar prej vitesh.  <i>(Biblioteka dhe menaxhim)</i>
<b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	GVJ konstaton se për programin e studimit Teknika Laboratorike Dentare, insitucioni ka ndërtuar laboratorë të dedikuar në mënyrë që studentët të praktikojnë njohuritë e tyre. Institucioni zotëron një bazë laboratorike moderne dhe shumë funksionale dhe i shërbejnë më së miri procesit mësimor, si edhe studimeve specifike. Laboratorët shfrytëzohen nga studentët nën kontrollin dhe udhëheqjen e stafit përkatës akademik dhe ndihmës. <i>(Vëzhgimi i ambjenteve)</i>
<b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet	Referuar RVB-së, dhe takimeve në insitucion u konstatua se UAL-LMS është sistemi kryesor i komunikimit dhe ndërveprimit në institucion i cili aksesohet nëpërmjet internetit. I gjithë stafi dhe studentët zhvillojnë të gjitha veprimtaritë nëpërmjet këtij sistemi qoftë proceset mësimore apo veprimtaritë e tjera administrative e

dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	kërkimore. Kjo platformë përdorej edhe për informimin e studentëve dhe zhvillimin e veprimtarive të tjera si takime, mbledhje, prezantime, diskutime etj. Në sistemin LMS çdo student ka akses dhe merr materialet mësimore të lëndëve të ndryshme, apo depoziton detyrat lëndore. <i>(Rregullore e veprimtarive online)</i>								
<b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	Studentët dhe pedagogët përdorin sistemin e brendshëm të komunikimit nëpërmjet përdorimit të adresave elektronike të fakultetit, google drive. Por sistemi me i rëndësishëm i komunikimit është ai i mësimdhënies së ofruar nga Universiteti (LMS). Ky system ka rezultuar një sistem të mirë komunikimi si dhe tëmesimdhënies. <i>(Rregullore e veprimtarive online)</i>								
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Programi i studimit nuk përfshin mbrojtje diplome me përgatitjen e një teme të vecantë nga çdo student por dhënien e një provimi përfundimtar i cili është një test përmbledhës i njohurive që studenti ka marrë gjatë të tre viteve akademike si dhe një provimi formimi praktik ku çdo student dorëzon punimin e vet individual laboratorik. <i>(Rregullore e diplomës) (Takimi me studentët)</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

#### Standardi III.4

**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimin të cilësisë së mësimdhënies.	Institucioni në funksion të përmirësimin të vazhdueshëm të mësimdhënies, ka ngritur strukturat përkatëse, të cilat janë: Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave. Praktikantët më të mirë, që evidentohen gjatë analizës mësimore, u bëhen të ditur të gjitha njësive bazë nëpërmjet një raporti që hartohet nga NJSBC. <i>(Rregullore e NJBSC)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Departamenti i Laborantit Dentar është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies. Departamenti, me anë të një programi vjetor aktivitetesh, workshop-esh dhe takimesh, synon rritjen e vetëdijes së stafit akademik dhe studentëve për cilësinë e programit të studimit. <i>(Takimet me stafin)</i>

<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Departamenti Laborant Dentar është struktura bazë e cila në bashkëpunim edhe me koordinatorene programit është përgjegjës për mbështetjen e eksperimentimin apo zhvillimin e metodave të reja të mësimdhënies. Çdo program ka koordinatorin përgjegjës i cili është koordinuesi i veprimtarive mësimore midis stafit dhe studentëve. Metodatat kryesore përfshijnë përfitimin e njohurive përmes teksteve të lëndës, leksioneve, prezantimeve individuale apo në grup, leksione të hapura, praktika laboratorike. <i>(Rregullore e Fakultetit të Shkencave Dentare)</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Nga takimi me stafin akademik të angazhuar në programin studimor, si dhe pas shqyrtimit të CV, konstatohet që personeli akademik dhe ndihmës përfshihen në projekte shkencore rajonale/ ndërkombëtare, seminare/ ëorkshop-e/ konferenca në fushat përkatëse të kërkimit shkencor. <i>(CV e stafit akademik)(Vizita në Institucion)</i> <i>(Mobilitete të stafit dhe studentëve)</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Departamenti Laborant Dentar si dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, organizojnë në mënyrë periodike ëorkshope dhe aktivitete të ndryshme trajnimi për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja. Këto aktivitete janë të afishuara në faqen e internetit të universitetit. <i>(Mobilitete të stafit dhe studentëve)</i></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Stafi akademiki programit të studimit Bachelor në “Teknika Laboratorike Dentare” dhe stafi mbështetës sipas përshkrimit të Statutit të institucionit janë përgjegjës për zbatimin e duhur të programit të studimit dhe janë të angazhuar për të përmirësuar mësimdhënien dhe zbatimin e metodave të reja përmes ndjekjes së vazhdueshme të planeve dhe strategjive të hartuara për këtë qëllim. Departamenti, gjatë mbledhjeve të përmuajshme, diskuton mbi këto metoda.<i>(Takimet ne UAL)</i></p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Gjatë takimit me stafin GVJ konstatoi se personeli akademik në takimet periodike të njësive kryesore/ ndihmëse ndan eksperiencat e implementimit të metodave të reja si dhe raporton me shkrim në fund të vitit një raport që përfshihet në analizën vjetore të drejtuesit të njësisë kryesore. Gjithashtu personeli akademik dhe ndihmës akademik trajnohet dhe teston metoda të reja mësimore. Këto trajnime realizohen kryesisht në kuadër të shkëmbimeve ndërkombëtare për trajnimin e stafit dhe objektivat, efektet dhe pritshmëritë prej tyre analizohen dhe raportohen në strukturat përkatëse. <i>(Mobilitete të stafit dhe studentëve)</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>



				X
--	--	--	--	---

### Standardi III.5

**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Institucioni dhe njësitë kryesore kanë hartuar dhe zbatojnë aktesh rregullatorë të cilat koordinojnë mënyrën e testimit dhe vlerësimit të njohurive. Universiteti informon studentët për të gjitha rregulloret, proceset, politikat dhe mekanizmat që udhëheqin studimet e tyre. Këto rregullore janë të publikuara edhe në faqen e Internetit të Universitetit. Rregullorja e institucionit parashikon në mënyrë të qartë modalitetet e vlerësimit. Procesi i vlerësimit është një shumatore e vlerësimit të vazhdueshëm dhe atij përfundimtar. UAL ka hartuar dhe miratuar rregulloren e posaçme për mësimdhënien online dhe testimin e njohurive. Komunikimi i rregulloreve nëpërmjet platformës online siguron informimin e plotë të studentëve. <i>(Rregullore UAL); (Rregullore provimesh online); (Udhëzues për provimet online)</i>			
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Studentët njihen me format e vlerësimit që në orët e para të mësimit. Kjo mundësohet nga ana e pedagogut të lëndës, gjatë njohjes së studentit me përmbajtjen e programit të lëndës. Syllabuset e lëndëve janë të publikuara në ndërfaqet e secilit kurs.  <i>(Syllabuset e lëndëve)</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Vlerësimi i përgatitjes së studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Nota përfundimtare është rezultat i një shumatore e vlerësimit të vazhdueshëm dhe atij përfundimtar (pjesëmarrja aktive, kolokiume, detyra/ projekte, provimi përfundimtar).  <i>(Takimi me studentët)</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.6</b>	
<b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	GVJ pas shqyrtimit të programit të studimit konstaton që testimi dhe vlerësimi i dijeve të studentëve të programit të studimit, realizohet përgjatë gjithë semestrit akademik me dy periudha kohore të dedikuara për provimet përfundimtare (semestrare/ vjetore). Sipas syllabusit përkatës të lëndës/ modulit provimet e ndërmjetme (kolokiume) dhe vlerësimi i vazhdueshëm bëhet gjatë semestrit me miniteste, projekte, detyra kursi. Programi i studimit ka profil të theksuar profesional dhe vlerësimi i studentit përveç njohurive, bazohet dhe në punimet individuale laboratorike. <i>(Rregullore e programit të studimit, syllabusit e lëndëve)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	UAL ka hartuar edhe platformën e provimeve online. Nëpërmjet platformës së edukimit online, personeli akademik përgatit bankën e pyetjeve me shpërndarje që ruan raportet sipas kapitujve të zhvilluara. Përzgjedhja e pyetjeve bëhet në mënyrë të tillë që provimi të mundësojë një vlerësim sa më real të studentit, të eliminojë forma të ndryshme abuzimi dhe të rrisë transparencën. Mjediset ku zhvillohen provimet janë të monitoruara me personel shërbimi që ka si detyrë kryesore ruajtjen e qetësisë dhe sigurisë për zhvillimin normal të procesit të provimeve. Në rastet e provimeve online nëpërmjet sistemit të menaxhimit, studenti zbaton rregulloren e posaçme të provimeve. Rregulloret e Institucionit janë të pasqyruara në faqen e internetit. <i>(Rregullore fakultetit) (Rregullore programi studimi) (Programi i studimit)</i>
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Testimet dhe provimet e parashikuara për lëndët/ modulet e programit të studimit zhvillohen gjithnjë me komisione provimi me të paktën dy pedagogë. Pedagogu i lëndës ka peshën kryesore në vlerësimin përfundimtar duke përfshirë dhe elementët e vlerësimit në vazhdim. Rezultatet përfundimtare të provimit janë bërë të ditur studentëve në platformën online. Detyrat, prezantimet në klasë, projektet, raste studimore, etj vlerësohen nga pedagogu i lëndës dhe asistenti mësimor. <i>(Rregullore programi studimi)</i>
<b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	Gjatë realizimit të provimit në auditor, vlerësimi i studentit me pikë shënohet në tezën e cila gjatë provimit pajiset nga sekretaria me barkod individual për çdo student dhe çkodohet pas korigjimit nga pedagogu. Institucioni ka siguruar infrastrukturë të mjaftueshme për zhvillimin dhe vlerësimin e provimeve në anonimat të plotë. Ndërsa gjatë provimit online studenti monitorohet në mënyrë të vazhdueshme nga personeli akademik apo ndihmës akademik si dhe

	nga sekretaria mësimore. Në fund të provimit studenti përfiton pikët përkatëse të grumbulluara të cilat më pas konvertohet në notë. (Rregulloret e provimit në auditor dhe online)			
<b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Vlerësimi i kompetencave dhe aftësive të studentit, përveç vlerësimit me pikë/ notë, shoqërohet me komente, veçanërisht në projekte, prezantime dhe forma të tjera të ngjashme vlerësimi. Gjatë takimit me studentët e programit u vu re perceptimi pozitiv mbi komentet, keshillat dhe rekomandimet e pedagogëve në mënyrë që të ndihmojnë studentët të përmirësohen në të ardhmen. (Rregullore programit të studimit) (Takimi me stafin dhe studentët)			
<b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra, nuk tolerohen nga personeli akademik.	Universiteti, nëpërmejt rregulloreve të hartuara, dënon kopjen dhe plagjiaturën. Studenti nuk tolerohet dhe penalizohet nëse vihen re raste të kopjimit apo të plagjiaturës gjatë realizimit të detyrimeve akademike të tij. (Rregullore Fakulteti i Shkencave Dentare)			
<b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Rezultatet e provimeve dalin brenda një afati prej 7 ditësh dhe u prezantohen studentëve në mënyrë individuale nga pedagogu i modulit. Rezultatet hidhen në sistem nga sekretaria mësimore pasi studentët janë njohur me vlerësimin. (Rregullore e sekretarisë)			
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	GVJ gjatë takimit me stafin, studentët dhe sekretarinë mësimore konstatoise studentët e ushtrojnë të drejtën e tyre për të kundërshtuar rezultatin e një vlerësimi duke u drejtuar me shkrim në departament. I gjithë ky proces dokumentohet. Në këtë program studimi nuk ka patur ndonjë rast kur ankimimi i studentit të ketë arritur në nivele të përgjegjës të departamentit. (RVB) (Rregullore fakulteti) (Takimi me studentët)			
<b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

**Standardi III.7**

**Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	GVJ është e mendimit se përmbajtja e programit të studimit Bachelor në “Teknika Laboratorike Dentare” i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje me nivelin e ciklit të parë të studimeve. Krahas njohurive shkencore teorike, programi synon aftësimin praktik të studentëve nëpërmjet laboratorëve dhe praktikave. <i>(Plani mësimor Ba në TLD)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Referuar planit mësimor 9.44% e kurrikulës është e përbërë nga lëndë të tipit D, që garantojnë zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë, sigurisë në laborator, komunikimit, dhe ndërveprimit si Bioetikë, Menaxhim shëndetësor, Italisht, praktikë profesionale etj. <i>(Plani mësimor, tab 8)</i> <i>(Syllabuset e programit)</i>
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Sipas syllabuseve në përfundim të çdo lënde përmbledhen, analizohen e shqyrtohen kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti. Pedagogu i lëndës, bazuar në këto informacione të mbledhura, rishikon çdo vit syllabusin dhe nisur nga analiza e zhvillimit të mësimin, sygjeron ndryshime me synim përmirësimin e pritshmërive nga studentët. <i>(Takimi me stafin akademik)</i>
<b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.	Stafi akademik orienton studentët në përfundim të çdo lënde për implementim e njohurive të marra teorike dhe praktike duke i pajisur me materialet e shpjeguara në çdo orë mësimi.  <i>(Takimi me studentët)</i>
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Stafi akademik me mbështetjen e Universitetit angazhohet në aktivitete shkencore, prezanton punën e tyre në konferenca dhe simpoziume, merr pjesë dhe organizon leksione të hapura, ëorkshope, si dhe zhvillon leksione në institucione ndërkombëtare në kuadër të Erasmus+. <i>(Takimet me stafin akademik)</i>
<b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në	Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash, të cilat u japin mundësi studentëve të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorët kompjuterikë si dhe në praktikat profesionale. Të gjitha praktikat laboratorike kryhen në laboratorët e vëna në dispozicion të këtij programi studimi të cilët janë të pajisur me aparatura dhe mjete të nevojshme e bashkëkohore.



laboratorë dhe praktikat profesionale.	<i>(Syllabuset e Lëndëve të programit të studimit) (Vizita në laborator)</i>			
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/ çështjeve të caktuara.	Diskutimet dhe puna në grup mbi interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave të ndryshme është listuar si një ndër kompetencat e programit Bachelor në Teknika Laboratorike Dentare. <i>(Kurrikula e programit të studimit) (Takimi me studentët)</i>			
<b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	Gjatë takimeve me stafin akademik dhe studentët GVJ vuri re që stafi akademik inkurajon, nxit dhe mbështet punën në grup të studentëve, në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave dhe për projektet e kursit.  <i>(Takimi me studentët)</i>			
<b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	GVJ nga vizita në universitet konstatoi se studentët marrin pjesë aktive në aktivitete të kërkimit shkencor me projekte të zhvilluara me mbështetjen e institucionit. Është vënë re një rritje e cilësisë së punimeve të studentëve nga viti në vit në prezantimet e tyre në konferencat e përvitshme shkencore studentore që Universiteti organizon. Studentët e FSHD prej vitesh marrin pjesë aktive në aktivitete të kërkimit shkencor me projekte të zhvilluara me mbështetjen e institucionit si dhe në klubet studentore për të zhvilluar dhe promovuar idetë e tyre inovative dhe aftësi të tjera. <i>(Rregullore e senatit studentor) (Rregullore e tutoriatit)</i>			
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Universiteti aktualisht ka pasur vëshitrësi për shkak të Covid-19 në realizimin e marrëveshjeve të vazhdueshme bashkëpunimi dhe në implementimin e plotë të tyre por procedurat janë shtyrë për një periudhë më të përshtatshme. Megjithatë zyra e projekteve dhe marrëdhënieve ka rol të rëndësishëm për ndihmën ndaj studentëve për të mundësuar dhe rritur mobilitetin. <i>(Mobilitetetë stafit dhe studentëve)</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi III.8

**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e	GVJ konstaton se institucioni ka një procedure të posaçme për provimin final, ose mbrojtjen e diplomës, e përshkruar edhe në

diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	rregulloren e institucionit dhe e bërë publike dhe e aksesueshme në faqen e internetit. <i>(Rregullore e Universitetit ALDENT) (Takimi me studentët)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Departamenti dhe stafi akademik vënë dispozicion të studentëve dhe publikon dhe në faqen online një program mbështetës për provimin përfundimtar, informacione dhe udhëzime. Pedagogët janë të disponueshëm për ofrimin e konsultimeve për studentët, në raste të caktuara gjatë përgatitjes së tyre për provimin përfundimtar.  <i>(Takimi me studentët) (Rregullore diplomimi)</i>
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Karakteret specifike profesionale të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Teknika Laboratorike Dentare”, ka orientuar modalitetet e diplomimit, përmes kombinimit të përgatitjes praktike të një punimi laboratorik protetik, ose ortodontik, dhe provimit të formimit teorik mbi lëndët profesionale të programit të studimit. Komisioni i Departamentit përgatit provimin e përgjithshëm përfundimtar bazuar në pyetjet e paraqitura nga secili pedagog i përfshirë në proces, sipas përqindjes së përcaktuar. <i>(Vendim dekani për komisionin e provimeve të diplomimit)</i>
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.	Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final teorik dhe praktik duke i organizuar konsultime me bankën orientuese të pyetjeve dhe asistuar në përgatitjen e punimeve laboratorike me vënien në dispozicion të laboratoreve protetike. <i>(Takimi me stafin dhe studentët)</i>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Universiteti ka vënë në dispozicion të studentëve infrastrukturën e nevojshme, si dhe staf ndihmës për të asistuar studentët në përgatitjen për provimin përfundimtar. Në shërbim të studentëve vihen informacione, udhëzime dhe të gjitha materialet e nevojshme. Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorët e tij, në mënyrë që ata të kryejnë punimet laboratorike për realizimin me sukses të provimit të formimit praktik. <i>(Rregullore e diplomimit)</i>
<b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.	Studentët orientohen për pjesën e provimit teorik të formimit me anë të një fondi pyetjesh, apo konspekti nga lëndët karakterizuese të programit, i cili u vihet në dispozicion me mbarimin e semestrit të fundit. Ndërsa për pjesën e provimit laboratorik studentët asistohen nga stafi laboratorik mësimdhënës.  <i>(Rregullore ediplomimit)</i>

<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Komisioni gjykon dhe vlerëson punimin laboratorik 0 – 60 pikë dhe provimit teorik të diplomimit nga 0 – 40 pikë . Dy pikëzimet e studentit mblidhen, për të rezultuar në vlerësimin përfundimtar të tij nga 0 – 100 pikë të interpretuara në notat përkatëse. Vlerësimi rezultat është përfundimtar e i pa kontestueshëm. <i>(Rregullore efakultetit) (Rregullore diplomimi)</i>			
<b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor dhe ka mbrojtur diplomën pajiset me diplomën përkatëse, të shoqëruar me fletën e notave të fituara gjatë viteve dhe suplementin e diplomës sipas standardeve ligjore në fuqi. <i>(Rregullore e diplomimit) (Formati i suplementit)</i>			
<b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve Institucioni vënë dispozicion të studentëve programin e plotë mësimor të nënshkruar nga Rektori.  <i>(Programi i studimit Teknika Laboratorike Dentare)</i>			
<b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Universiteti arkivon dokumentacionin e studentit pas diplomimit në zyrat e arkivës. Rast pas rasti, bazuar në kërkesat specifike të studentëve, lëshohen vërtetime për qëllime të ndryshme.  <i>(RVB); (Takimet në AUL)</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X



<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA  
PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Departamenti Laborant Dentar përgjegjës për këtë program studimi mbledh dhe ruantë dhëna në lidhje me stafin akademik të përfshirë në mësimdhënie, ku përfshihen lista e personelit akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme që aktivizohen çdo vit, lëndët/modulet që zhvillon secili prej tyre, ngarkesa për çdo disiplinë, ngarkesa semestrale dhe ajo totale. Ruajtja dhe përditësimi i të dhënave bëhet në dosjen e personelit. Dosjet e personelit akademik efektive dhe atij me kontrate janë të plota. Grupi i vlerësimit verifikoi disa prej tyre. Gjatë takimit në Zyrën e Burimeve Njerësore GVJ u interesua të njihet me zbatimin e procedurave të rekrutimit të personelit dhe gjeti që ato ishin kryer konform akteve ligjore e nënligjore.</p> <p><i>(Rregullore e Universitetit ALDENT)</i> <i>(Takimi në Zyrën e Burimeve Njerësore)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>GVJ konstaton se fakulteti në bashkëpunim me zyrën e burimeve njerësore mban rekordet e procesit të rekrutimit dhe të të dhënave të kandidatëve aplikues si dhe shpalljen e fituesve dhe kjo procedurë ndiqet me rigorozitet e transparencë. Institucioni disponon një procedurë për punësimin e personelit akademik. Departamenti parashtron vendet e lira në përputhje edhe me planin mësimor. Nevoja për personel akademik bëhet publike duke specifikuar specialitetin e duhur dhe kriteret që duhet të plotësojë çdo kandidat. Dosjet e kandidateve shqyrtohen nga komisioni i rekrutimit. Pasi komisioni i rekrutimit të stafit bënte vlerësimin e personelit akademik, zyra e burimeve njerësore angazhohej në hartimin e kontratës mes palëve. <i>(Procedura e rekrutimit të stafit)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe</p>	<p>Procesi i rekrutimit mbështetet në nevojat për personel, të cilat i paraqiten Zyres së Burimeve Njerësore nga të gjitha departamentet</p>

<p>vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>dhe njësitë kryesore. Zyra e burimeve njerëzore që drejton të gjithë procesin e fillon atëpasi merr kërkesën nga njësi bazë. Vendet vakante të lira bëhen publike në faqen e internetit të IAL. Pas shpalljes dhe marrjes në dorëzim të dosjeve të aplikantëve, ngrihet komisioni përkatës me 5 persona ku të paktën 3 janë anëtarë të departamentit i cili shqyrton dosjet sipas një sistemi pikëzimi të miratuar më parë. GVJ gjykon që procedura e rekrutimit të stafit garanton rekrutimin e personelit në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. Komisioni i vlerësimit bën renditjen e kandidatëve që plotësojnë në mënyrë të mirë kërkesat për vendin e punës dhe ja përcjell dekanit të fakultetit. (Procedura e rekrutimit të stafit); (Takimi në Zyrën e Burimeve Njerëzore)</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p>X</p>

<p><b>Standardi IV.2</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efikente dhe efektive</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Personeli akademik dhe ai administrativ ka në dispozicion ambiente të dedikuara si dhe instrumenta të nevojshëm (kompjuter, lidhje internet, kancelari, etj) për kryerjen e aktiviteteve mësimore dhe administrative. Ambjentet e mësimdhënies gjatë vizitës në institucion janë të pajisura me të gjitha mjetet e nevojshme didaktike. Ambjentet janë të hapura dhe të aksesueshme nga i gjithë personeli akademik. (Vizita në IAL)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se Universiteti Aldent, referuar edhe RVB organizon vazhdimisht trajnime për stafin akademik me qëllim aftësimin profesional të stafit. Stafi akademik ishte inkurajuar të merrte pjesë në projektet e shkëmbimit si: CEPUS dhe ERASMUS+ gjithashtu stafit akademik u krijohen mundësitë dhe kushtet e nevojshme për të marrë pjesë edhe në trajnime profesionale jashtë institucionit. (Takimi me stafin akademik)</p>





<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni organizon trajnime pedagogjike që lidhen me metodologjitë më efektive të mësimdhënies. Bazuar në takimin me stafin akademik dhe platformës UAL-LMS rezulton se UAL në kuadër të procesit mësimor zbaton metoda të ndryshme të mësimdhënies dhe testimit të njohurive, përdor module specifike për të mbështetur metodat inovative të mësimdhënies si krijimi i klasave virtuale, shkëmbimi i materialeve me studentët, ndërveprimi dhe komunikimi me studentët, përditësimi i ndërfaqes personale të pedagogut. Përfshirja e stafit akademik të huaj, kryesisht në programin e ciklit të tretë, ndihmon personelin e UAL të rrisë performancën e vet, nivelin e bashkëpunimit dhe kërkimit shkencor.</p> <p>GVJ konstaton se institucioni ka angazhim maksimal të burimeve njerëzore në përbushje të objektivave të këtij programi studimi.</p> <p><i>(Tabelat RVB Ba në TLD, tabelat nr.4)</i></p>								
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="608 786 791 869">Nuk përbushet</th> <th data-bbox="796 786 1002 869">Përbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1007 786 1211 869">Përbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1216 786 1437 869">Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="608 869 791 907"></td> <td data-bbox="796 869 1002 907"></td> <td data-bbox="1007 869 1211 907"></td> <td data-bbox="1216 869 1437 907">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

### Standardi IV.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe evidencën nr. 14 si dhe vizitën në institucion, rezulton se UAL vë në dispozicion ambjente të bollshme dhe shumë të përshtatshme për zhvillimin e procesit të mësimdhënies duke marrë në konsideratë numrin e studentëve dhe specifikën e programit të studimit. Auditorët, laboratorët, dhe mjediset ndërmjetëse ishin të gjitha funksionale. Gjithashtu UAL ka në dispozicion dhe kampusin e ri të sapo ndërtuar ambjente të dedikuara për një proces akademik me standarde të larta logjistike, me hapësira të mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, praktike e laboratorike. <i>(RVB); (Vizita në institucion)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive</p>	<p>Të gjitha sallat janë të pajisura me orëdi të përshtatshme për zhvillimin e mësimin dhe me mjetet e nevojshme teknologjike: kompjuter, videoprojektor etj, në funksion të mbarëvajtjes së mësimdhënies. E gjithë godina mbulohet nga rrjet interneti ëireless, e disponueshme për të gjithë.</p> <p><i>(Vizita në institucion)</i></p>



bashkëkohore të mësimdhënies- mësimnxënies.									
<b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Laboratorët janë të pajisur me aparatura dhe mjete mësimore bashkëkohore, të mjaftueshme në numër për kryerjen e orëve laboratorike. Laboratorët, janë të disponueshëm për studentët gjatë orëve të mësimin, për përgatitjen e detyrave të kursit, punimeve laboratorike praktike apo studimeve të tjera nga ana e tyre, nën kujdesin e laborantëve.  (Vizita në institucion) (Takimi me studentët)								
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.	Në Laboratorin e Informatikës , kompjuterat kishin parametra të përshtatshme për të suportuar softëare në versionet e tyre më të fundit ku zhvillohet lënda e Informatikës dhe Statistikës. Në mjediset e fakultetit gjatë vizitës GVJ konstatoi se interneti Ëi-Fi ishte i aksesueshëm dhe në dispozicion të studentëve. (Vizita në institucion, turi i ambjenteve) (Takimi me studentët)								
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	Referuar RVB si dhe gjetjeve gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se për programin mësimor Bachelor në Teknika Laboratorike Dentare mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe njëkohësisht të posaçme si për zhvillimin e leksioneve e seminareve dhe laboratorëve të programit të studimit.  (Vizita në institucion, turi i ambjenteve)								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të Procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të	Gjatë vizitës në Institucion GVJ konstatoi se në dispozicion të studentëve ishin biblioteka mësimore me salla leximi të pajisura me vende leximi dhe internet. Referuar RVB-së, biblioteka përmban rreth 13 mijë e pesëqind tituj librash në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj të klasifikuar sipas profileve dhe disiplinave. Personi i

<p>barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>ngarkuar me bibliotekën ishte i gatshëm për t'i ndihmuar të interesuarit për të gjitha shërbimet. Për bibliotekën dhe teknologjinë ishin vënë në dispozicion dy salla me kapacitet rreth 75 poste leximi, 50 poste interneti të pajisura me kompjuter dhe funksionale. (Biblioteka, vizita në institucion)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka kishte një fond të madh librash të skeduar dhe të moduluar sipas programeve të studimit që ofron institucioni. Biblioteka ofronte si shërbimin me personel ashtu edhe shërbimin online. UAL kishte disa vjet që vinte në dispozicion edhe bibliotekën on-line "Hinari" bibliotekë e OBSH. Kompjuterat e instaluar në ambjentet e bibliotekës ofrojnë akses pa kufizim interneti. <i>U vu re prania e një numri jo shumë të madh të titujve në gjuhën shqipe të lidhura me këtë program studimi.</i> Kjo është plotësuar me cilket e leksioneve të shkruara dhe të hartuara nga pedagogët përgjegjës të lëndëve. Këto materiale hidheshin rregullisht edhe në platformë UAL-LMS të Universtitet. (Biblioteka, vizita në institucion)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni është abonuar prej disa vitesh në bibliotekën "Hinari", bibliotekë e Organizatës Botërore të Shëndetësisë në funksion të stafit dhe studentëve nëpërmjet kompjuterave me akses pa limit me internet të instaluar në ambjentet e bibliotekës. Biblioteka ishte e pajisur me sallë lexime me poste kompjuterike.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Institucioni akordon çdo vit një fond të përshtatshëm për literaturë bazuar në kërkesat e departamentit. GVJ iu vu në dispozicion edhe lista e teksteve periodike në Bibliotekë të shtuara në vitet e fundit në funksion të programit të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Punonjësi i ngarkuar me bibliotekën iu përgjigj se numri i vendeve ishte i mjaftueshëm, ndërsa orari i frekuentimit ishte funksional në përshtatje të orarit mësimor studentëve dhe në përputhje me nevojat e tyre. (Biblioteka, vizita në institucion)</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të Procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>(Takimi me stafin akademik) (Lista e teksteve periodike në bibliotekë të shtuara në vitet e fundit në funksion të programit të studimit)</p>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit**


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Sekretaria mësimore është përgjegjëse për ruajtjen, menaxhimin dhe përditësimin periodik të të dhënave të studentëve nga regjistrimi deri në diplomim. GVJ konstaton që Universiteti Aldent disponon sistem të menaxhimit të informacionit me të cilin administron gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre deri në diplomim. Në vizitën e kryer në sekretari nuk u gjetën parregullsi. Dosjet e studentëve ishin të plota. Stafi akademik, ndihmës-akademik dhe administrativsi dhe studentët kanë adresën e vet të e-mail-it, të cilën mund ta aksesojë në çdo kohë brenda dhe jashtë universitetit. Përmes sistemit UAL-LMS, studentët aksesojnë të dhënat personale, rezultatet e provimeve sipas semestrave apo viteve akademike, si dhe të dhëna të tjera didaktike.</p> <p><i>(Vizita në sekretarinë )</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sistemi i brendshëm i menaxhimit funksiononte më së miri duke administruar të gjitha veprimtaritë në mënyre kompjuterike (online) dhe fizike (në dosje) . Informacionet që lidhen me aktivitetin e personelit akademik efektiv dhe me kontratë si dhe atij ndihmës akademik ruhen në Departament dhe në Zyrën e Burimeve Njerëzore. Dosjet ishin të plota, me të gjithë informacionin dhe të dhënat personale të personelit: CV, ID, Diplomat e kualifikimit, librezë shëndetsore, raporti mjeko-ligjor, librezë e punës, kontrata e angazhimit, etj. Në mënyrë periodike bëhet azhurnimi i CV-ve kur merren titujt me të lartë akademike, kryen trajnime të edukimit në vazhdim, botohen apo publikohen artikuj e referime.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi Fx Education siguron akses të vecantë për secilën kategori si për sekretarinë, stafin dhe studentët. Secili grup kishte hapësirën e vet në këtë sistem ku mund të logohej me të dhënat personale dhe të marrë informacionin për të cilin ka akses e cila siguron akses të dedikuar në informacione dhe dokumente si për personelin, ashtu edhe për studentët e programit të studimit. Ky sistem integron platformën e edukimit në distancë UAL- LMS, nëpërmjet së cilës pedagogët dhe studentët mund të komunikojnë në grup ose</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë formë të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit</p>	

ndërmjet personelit dhe studentëve.	individualisht, të përcjellin materialet e modulit, të kontrollojnë projektet apo të diskutojnë virtualisht mbi modulën mësimor.			
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Sistemi monitorohej në kohë reale nga IT e universitetit të cilët përgjigjen për çdo problematikë dhe vazhdimisht kryenin raportime lidhur me ecurinë e sistemit. Faqja zyrtare e UAL është aktive në dy gjuhë shqip dhe anglisht, dhe siguron informacion të azhurnuar periodikisht në lidhje me mësimdhënien dhe mbarëvajtjen e procesit mesimor në këtë program studimi.			
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	<i>(Manual i përdorimit të platformës Fx Education) (Ndërfaqe të platformës UAL- LMS.)</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi IV.6</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e Procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	GVJ konstaton se UAL ka buxhet të pavarur dhe harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e tij për cikël të plotë studimi. Buxheti vjetor miratohet nga Bordi i Administrimit të Universitetit pasi kalon nëpër disa faza diskutimesh ku paraqiten nevojat dhe shqyrtohen mundësitë. Fillimisht nevojat paraqiten duke plotësuar formularë të standartizuar të cilat dërgohen në njësitë kryesore, njësitë bazë dhe njësitë e tjera.
<b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të Procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet	Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua edhe lidhur me financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendëse dhe të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit. Nga ky informacion ai mësoi që burimi kryesor i financimit ishin të ardhurat nga tarifat e studentëve

<p>financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>ndërsa fondet e tjera lidheshin me të ardhurat nga projektet kombëtare dhe ndërkombëtare. Shpërndarja e këtyre fondeve bëhej nga Zyra e Financave bazuar në zërat e miratuara në buxhet.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Plani i financimit përshkruan të gjitha kostot e një programi studimi. Ai përmban financimin e burimeve njerëzore dhe infrastrukturore, pajisjet, materialet e konsumit për zhvillimin e laboratorëve dhe praktikave mësimore e spitalore, fondin për pasurimin e bibliotekës dhe aksesin në bibliotekat on-line, kostot e auditeve të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe mundësitë e mbështetjes financiare të projekteve të UAL. Çdo fund viti akademik hartohen pasqyrat financiare, ku përcaktohet gjëndja financiare dhe realizimi i Projekt - Buxhetit të UAL. Institucioni kryen çdo vit auditimin edhe pse, duke qënë një institucion jo publik trajtohet si biznes me të drejtat dhe detyrimet ndaj punonjësve, studentëve dhe shtetit.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Çdo vit institucioni përpilon pasqyrat financiare:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Pasqyra e pozicionit financiar (Balanci kontabël);</li> <li>▪ Pasqyra e performancës (Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve);</li> <li>▪ Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare;</li> <li>▪ Pasqyra e Ndryshimit të Kapitalit Neto</li> </ul>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Situata financiare dhe bankare dëshmon se Universiteti Aldent ka qëndrueshmëri financiare pa detyrime ndaj të tretëve përgjatë kohës së zhvillimit të këtij programi studimi dhe ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësim të mëtejshëm dhe gjenerim të të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen. Nga raportet financiare të UAL dëshmohet se, institucioni ka rritje ekonomike nga viti në vit. Rritja ekonomike, citohet në RVB, i ka shërbyer rritjes së cilësisë, shtimit të laboratorëve dhe përmirësimit të infrastrukturës së UAL.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>(Strategjia e zhvillimit.)</p>			
	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p>X</p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p>X</p>



## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Institucioni, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore, zbaton politika dhe procedura, të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta, për të gjithë kandidatët për studentë, duke mundësuar ndjekjen korrekte të kandidatit që nga momenti i aplikimit, më pas regjistrimit dhe deri në përmbylljen e detyrimeve akademike dhe diplomimin e tij.
<b>Kriteri 2.</b> Politikën dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Këto politika dhe procedura shprehen në planin strategjik të universitetit, Statutin e Universitetit, Rregulloren e Universitetit dhe në rregulloren e fakultetit. Në rregulloren e programit shprehet qartë garantimi i barazisë dhe i të drejtave të njëjta për të gjithë kandidatët dhe studentët e universitetit.
<b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Bazuar në kriteret kombëtare dhe propozimit të ardhur nga njësia para çdo fillim viti akademik, në afatet e përcaktuara nga MASR për aplikimet pranë ambjenteve të Universitetit organizohet fushata e informimit. Stafi i ngarkuar për informim pret dhe sqaron të interesuarit me informacionin e nevojshëm për pranim. Para fillimit të vitit akademik institucioni organizon fushatën e informimit për të gjitha programet e studimit. Në afatet e përcaktuara nga MASR për aplikimet, pranë ambjenteve të Universitetit stafi i ngarkuar për informim pret dhe jep gjithë informacionin e nevojshëm për pranim. Cdo vit akademik që në muajin shkurt në portalin U-Albania hidhen të gjitha kriteret e pranimit për studentët që do të aplikojnë në fund të muajit korrik. Po ashtu këto kriteret pasqyrohen në ëëbsitin e Universitetit dhe në rrjete e tjera sociale që Universiteti posedon.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj të cilët regjistrohen si çdo maturant nëpërmjet sistemit U-albania në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin. Gjithashtu në parashikimin e kuotave vjetore, kuota të veçanta kanë dhe studentët nga trojet, si Kosova, Mal i Zi, Maqedonia të cilët hynë pasi bëjnë njehsimin e diplomës së tyre të shkollës së mesme pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe plotësojnë kriteret për tu pranuar.
<b>Kriteri 5.</b> Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	
<b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni	<i>(Statuti i UAL) (Rregullore e UAL)</i> <i>(Rregullore e programit të studimit)</i>

udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	<i>(Takimi me dekanin, studentët) (RVB)</i> <i>(Vendim Senati mbi Kriteret e pranimit në programin e studimit)</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi V.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Përgjegjësi i programit të studimit informon për rregulloren e programit, kushtet e frekuentimit, format e kontrollit të dijeve, konvertimin e pikëve në notë si dhe kriteret për të kaluar në vitin pasardhës. <i>(Rregullore e programit të studimit.)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Në rregulloren e programit të studimit përcaktohen dhe specifikohen kriteret dhe procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme dhe transferimit të krediteve. Dekani i Fakultetit ngre komisionin e vlerësimit të ekuivalentimit. <i>(Rregullore e programit të studimit.)</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Gjatë javës së parë të vitit akademik, institucioni organizon ditët orientuese, gjatë të cilave studentët informohen mbi procedurat e ndryshme që ndjekin mbarëvajtjen e studimeve të tyre. Gjatë orëve të para të mësimit, gjithashtu, pedagogët njohin studentët me përmbajtjen e syllabusit të lëndës, në të cilën përfshihen edhe format e vlerësimit konkret për secilën lëndë.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Përgjegjësi i programit të studimit informon mbi procedurën e diplomimit në fillim të ciklit të studimeve duke ju vënë në dispozicion studentëve informacionin mbi procedurat e punimit të provimit të formimit nëpërmjet faqes zyrtare, katalogut të shkollës, fletëve informuese. Veprimtaria informuese intensifikohet në muajin shtator si periudhë informuese.
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të	Institucioni fillon informimin e maturantëve gjatë ditëve të informimit të organizuara nga MASR, dhe më pas në vazhdim për kandidatët e interesuar për programet e studimit që ofron me informacione më të detajuara mbi përmbajtjen e programeve të studimit dhe kriteret për pranimin në to. <i>(Rregullore e programit të studimit.); (Syllabuset); (Formati i diplomës, Suplementi i diplomës); (RVB)</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 45

ardhshëm mbi programin e studimit.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi V.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	GVJ vëren se, studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin e procesit mësimor, kohëzgjatjen e programit të studimeve nëpërmjet kalendarit akademik të prezantuar nga përgjegjësi i programit.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Në fillim të çdo semestri, studentët njihen nga pedagogët e lëndëve me përmbajtjen e syllabuseve, me organizimin e lëndës në leksione/ seminare/ ushtrime/ laboratore/ detyra kursi, mënyrën e vlerësimit, literaturën e detyruar dhe atë të rekomanduar. Nëpërmjet Zyrës së Këshillimit të Karrierës, institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit dhe ofron për ta mbështetje institucionale. Pedagogët në diskutime me studentët u japin informacion studentëve në lidhje me kompetencat që fitojnë në këtë program studimi dhe mundësitë që kanë për punësim. Zyra zhvillon aktivitete të edukimit në vazhdim dhe mban kontakte me studentët të diplomuar për ndjekjen e karrierës së tyre profesionale. Studentët informohen dhe përditësohen me organizimin e procesit mësimor nëpërmjet orareve mësimore, orareve të praktikave etj. Referuar RVB, kjo zyrë edhe e trajnon edhe e mbështet studentin në krijimin e dokumentacionit sa më të përshtatshëm për të konkuruar në tregun e punës. Zyra ndërmjetëson kontaktet dhe i finalizon ato. Në platformën UAL-LMS dhe Fx Education e njohurhollësisht dhe përdorur nga studentët, informacioni në lidhje me programin e studimit dhe organizimin e Procesit Bachelor në Teknika Laboratorike Dentare është i plotë.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	Nëpërmjet faqes zyrtare të Universitetit Aldent, studentët mund të përdorin edhe rubrikën "portal i studentit", në çdo kohë dhe nga çdo pajisje elektronike të lidhur me internet.
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	(Manual perdorimi Fx) (Ndërfaqe të platformes UAL- LMS) (Tabelat RVB Ba në TLD)
<b>Kriteri 5</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
<b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimit në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</b>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	Në sekretarinë mësimore mbahet regjistri i të diplomuarve, në të cilin regjistrohen të diplomuarit në vite sipas programeve të studimit. <i>(Takimi në sekretarinë)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Institucioni mirëmban regjistrin themeltar, ku janë të regjistruar studentët në vite, si studente të regjistruar për herë të parë, ashtu edhe ata të transferuar nga universitete të tjera. Në regjister hidhen të gjitha të dhënat në lidhje me progresin akademik të studentëve, që nga pranimit deri në diplomim, ata që janë larguar apo që përsërisin vitin. Referuar vizitës në sekretarinë mësimore u konstatua se numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi për tre vitet akademike ishte:
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimit deri në diplomimin e tyre.	Për vitin akademik 2018 - 2019 43 studentë; Për vitin akademik 2019- 2020 48 studentë; Për vitin akademik 2020- 2021 48 studentë; <b>Totali për një cikël studimi 139 studentë;</b> <i>(Takimi në sekretarinë)</i>
<b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve në formën e dokumentacionit fizik (proçesverbale, regjistra), si edhe në formën elektronike në platformën Fx Education. Sekretaria mësimore është përgjegjëse për ruajtjen, menaxhimin dhe përpunimin e të dhënave që lidhen me studentët. Sistemi i menaxhimit të tyre është i sigurtë dhe lehtësisht i aksesueshëm nga personat e autorizuar në varësi të detyrës <i>(sekretaria, dega mësimore, tutori akademik)</i> .
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilit dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në	GVJ konstatoi se institucioni harton raportin vjetor për të gjitha njësitë, ku mes të tjerash analizohet cilësia e studentëve në hyrje dhe në dalje dhe sygjerohen masa për përmirësim.

drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi V.5


**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Në statutin dherregullorja e UAL, parashikohet përfshirja e studentëve në hallkat vendimmarrëse dhe këshilluese, në plotësim të kërkesave të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Studentët përfaqësohen në Senatin Studentor, me një senator për çdokurs, si dhe në komisione të tjera me përfaqësues studentësh si NJSBC, komisioni i kurrikulave, grupi i punës GVB, komisioni i kërkimit shkencor, senati akademik.</p> <p>Kjo u konstatua dhe në dokumentacion e vënë në dispozicion ku Senati , NJSBC, grupi i punës RVB e kishin prezent përfaqësuesin studentor.</p> <p>Studentët gëzojnë të drejtat e tyre që respektohen nga stafi akademik, administrativ, sekretaria dhe drejtuesit e institucionit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Institucioni në vazhdimësi është i hapur dhe me vëmendje të veçantë për propozimet e studentëve. Këtu ka një rol të rëndësishëm alumini ku IAL mbante kontakte të vazhdueshme me studentët që vazhdojnë cikle të tjera jashtë vendit apo që kanë aplikuar për njohje diplome dhe këta studentë jepnin opinionet e tyre për përmirësimin e kurrikulës konform programeve të ngjashme në vendet përëndimore.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në Procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Në bazë të anketimeve të përvitshme dhe mbledhjeve të tutoriatit për këtë program studimi mblidhen opinione që reflektohen në departament nga ku lindin sugjerimet për përmirësimin e kurrikulës.</p> <p>Studenti ka të drejtë të njihet me tezën e provimit pas korigjimit, ta rishikojë dhe ankimojë atë. Lihet nje afat kohor prej 7 ditësh nga deklarimi paraprak i notes ne sistemin online, ku priten ankimimet</p>



<p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së Procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>prane sekretarise mesimore apo pedagogut tutor duke caktuar me pas nje date kur ne prezencen e pedagogeve te komisionit te provimit dhe studentit rishikohet teza. Per te qene transparent gjate korigjimit, provimet kryhen me sistemin e sekretimit dhe pedagogu i korigjon provimet pa e ditur se kujt i perket teza e provimit. Per cdo problem lidhur me barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së Procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, studenti ka të drejtë të shprehe mendimin e tij të lirë në mënyrë anonime gjatë pyetësorëve të herëpashershëm që IAL organizon. (Rregullore e Senatit studentor) (Statuti i UAL) (Rregullore e Universitetit ALDENT) (Takimi me stafin, Takimi me studentët)</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p>X</p>

<p><b>Standardi V.6</b></p>	
<p><b>Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Informacionet bazë studentët i marrin nga faqja zyrtare e institucionit e cila është vazhdimisht e përditësuar si dhe nga zyrat përkatëse. Në Universitetin Aldent Zyra e Informimit dhe Këshillimit të Karrierës mbledh, përpunon dhe ruantë të dhënat mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit edhe të studentëve në programin e studimit Teknika Laboratorike Dentare.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me Procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Orientimi dhe këshillimi i studentëve nis me informimin e maturantëve mbi programet e studimit të ofruara në bashkëpunim të ngushtë me departamentin, dhe vazhdon deri pas përfundimit të studimeve, nëpërmjet Zyrës së Karrierës dhe Alumnit. Institucioni përmes departamentit ofron udhëheqje dhe kujdestari (tutoriat) për studentët, gjatë gjithë periudhës së studimeve.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar</p>	<p>Departamenti ndihmon studentët që hasin vështirësi për përvetësimin e lëndëve, apo plotësimin e detyrimeve të ndryshme të programit të studimit, nëpërmjet orëve të konsultimit të zhvilluara me pedagogët. Nga takimi me studentët, doli që ndihma e pedagogëve nëpërmjet</p>



informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e Procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	konsultimeve dhe materialeve ndihmëse ishte shumë efektive.			
<b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	(Rregullore e tutoriatit) (Studim tregu Ba në TLD)			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Institucioni në përputhje me legjislacionin në fuqi të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë: "Institucionet e Arsimit të Lartë janë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë" ka hartuar politika në nivel institucional, si dhe ka ngritur strukturat përkatëse deri në nivel njësie bazë, të cilat merren me monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, nëpërmjet përdorimit të instrumenteve të duhur.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Institucioni ka ngritur një Sistem të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, për të cilën Senati Akademik ka miratuar rregulloren e Rregulloren e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJSBC) është ngritur dhe funksionon në përputhje me rregulloren specifike hartuar sipas të drejtave dhe detyrimeve statutoe. Kjo strukturë funksionon në bazë të elementëve të mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbështet dhe ofron ekspertizë në zhvillimin e proceseve të sigurimit të cilësisë;</li> <li>• Bashkërendon procesin ndërmjet njësive në nivel institucional;</li> <li>• Interpretin detyrimet kombëtare dhe europiane të sigurimit të cilësisë;</li> <li>• Monitoron procesin, ofron udhëzime, mbledh informacione, evidenton probleme;</li> <li>• Administron dokumentacione, organizon dhe përgatit vizita të vlerësimit të jashtëm;</li> <li>• Përcakton pyetësorët në nivel institucional për matjen e cilësisë në disa nivele;</li> <li>• Lehtëson krijimin e një mjedisi të favorshëm me studentin në qendër, për arsimim cilësor dhe zhvillimin e stafit akademik për një proces me pjesëmarrje aktive gjatë mësimdhënies dhe mësimnxënies;</li> <li>• Siguron informacion për cilësinë e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të Universitetit;</li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Kjo njësi ka në përbërje grupin përkatës ku përfshihen përfaqësues të Fakulteteve, një ekspert i jashtëm dhe një përfaqësues i Unionit Studentor, i cili vlerëson periodikisht cilësinë dhe efikasitetin e veprimtarive mësimore-kërkimore për personelin akademik dhe studentët, si edhe aktivitetin administrativ të institucionit. Ky grup është i pavaruar dhe siguron ushtrimin e kompetencave të strukturave përbërëse të institucionit në përputhje me kujtitë e autonomisë që ato gëzojnë sipas statutit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 51

	<p>NJSBC ndjek implementimin e standarteve akademike dhe institucionale përmes kontrolleve dhe raporteve në mënyrë periodike.</p> <p>Sigurimi i jashtëm i cilësisë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit në bashkëpunim me ASCAL.</p> <p>Njësia e brendshme e sigurimit të cilësisë çdo fund viti akademik publikon raportin vjetor i cili bëhet publik në faqen e ëebit të Universitetit Aldent.</p> <p>Njsbc monitoron dhe vlerëson procedurat dhe standartet, duke analizuar dhe krahasuar rezultatet në bazë të treguesve të cilësisë, në bazë të kritereve dhe standarteve të paracaktuara për krijimin e kulturës së cilësisë në institucion.</p> <p><i>(Strategjia e zhvillimit UAL 2016-2021)</i>  <i>(Rregullore e Universitetit ALDENT)</i>  <i>(Rregullore e NJSBC)</i>  <i>(Tabelat RVB , tabela 21)</i>  <i>(Takim me përfaqësues të Njsbc)</i>  <i>(Raporti i pyetësorit)</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi VI.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.	Departamenti Laborant Dentar dhe Fakulteti i Shkencave Dentare si njësi ofruese e programit të studimit së bashku me NJSBC vlerësojnë cilësinë e programit të studimit. Njësia ofruese e programit të studimit monitoron ecurinë e programit të studimit si edhe vlerësojnë syllabuset e lëndëve konform planit mësimor.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.	UAL ka hierarki funksionimi dhe përdor mekanizma e procese formale të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herë pas hershme të programit të studimit. Çdo fillim viti akademik bëhet përditësimi i syllabuseve nga titullarët e lëndës. Institucioni organizon audite të brendshme të drejtuar nga NJSBC për dokumentacionin e çdo programi dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	Institucioni përdor metodologji vlerësimi sitreguesite performancës akademike apo pyetësorin e studentëve. Rezultatet paraqiten në raporte vjetore vetëvlerësimi dhe ikalojnë Rektorit i cili i raporton në Senat për të marrë masat dhe vendimet e duhura për përmirësimin e performancës dhe cilësisë. Njsbc çdo fundviti akademik publikon Raportin Vjetor, në përmbajtjen e të cilit
<b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve	

përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	përshkruhet edhe plani i masave për përmirësimin e treguesve me vlerë të ulët.			
<b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	<i>(Pyetësoni i studentëve)</i> <i>(Raporti i pyetësorit)</i> <i>(Formulari i performances akademike)</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>


### Standardi VI.3

**Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësi e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	GVJ mbështetur në raportin e dorëzuar dhe takimeve në institucion konstaton se NjSBC harton Raportin Vjetor të saj , mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, i cili vihet në dispozicion të rektoratit. Këto të dhëna janë bazë për vlerësimin e brendshëm të programeve të studimit dhe vetëvlerësimit. Gjithashtu institucioni kryen një vlerësim të brendshëm vjetor gjithëpërfshirës që përfshin gjithë programet, njësitë kryesore/ bazë dhe ndihmëse që e paraqet në një raport vjetor të Universitetit i cili shërben si një historik për performancën institucionale. Ky raport i përvitshëm dërgohet konform legjislacionit edhe në MASR.
<b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	GVJ konstatoi se Universiteti Aldent për shkak të profilit mjekësor përdor në mënyrë periodike instrumenta specifike dhe në përputhje me fushën akademike. GVJ konstatoi që UAL përdor metoda të drejtëpërdrejta dhe të tërthorta për të vlerësuar cilësinë e programit të studimit. Këto metoda përdoren periodikisht, dokumentohen përmes raporteve dhe iu dërgohen autoriteteve drejtuese.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtëpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, teste lokale apo të	Të drejtëpërdrejta: a. Këto informata merren nga Institucionet relevante. b. Staf i akademik dhe Administrativ i Universitetit, fton studentët në diskutime të hapura, dhe ju mundëson atyre shprehjen e lirë të gjitha çështjeve që lidhen me Procesin arsimor. c. Vlerësimi i studentëve bëhet në format e përcaktuara ligjore të cilat janë inkorporuar në Statutin, Rregulloren e përgjithshme dhe në Programet e veçanta të studimit.

<p>standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>d. Të gjitha këto janë pjesë e dokumentacionit mësimor (proçes verbale) të cilat janë në përputhje me legjislacionin dhe aktet rregullative.</p> <p>e. Për vlerësimin e studentëve përdoren të gjitha format ligjore, përfshi këtu Testimet , Seminaret, Detyra Kursi, Projektet, Prezantime në Poëer Point, etj.</p> <p>f. Të gjithë studentët gjatë kryerjes së Praktikave të tyre mbikqyren nga përgjegjësit e caktuar.</p> <p>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e Tezës, janë gjithmonë çështje e vlerësimit permanent.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Metodat e tërthorta:</p> <p>a. Sondazhe nëpërmjet pyetësorëve të studentëve, ku ata mund të shprehen në kushte anonimiteti për të gjitha këto proçese.</p> <p>b. Sistemi i Tutorëve/ Kujdestarëve të Grupeve të studentëve, mundësojnë në mënyrë permanente intervistimin e studentëve për të gjitha aspektet e Proçesit arsimor.</p> <p>Departamenti përgatit raport mbështetur në rezultatet e anketimit. Rezultatet e të gjitha anketave përpunohen dhe shërbejnë vlerësimit të mbarëvajtjes së programit. (Analiza vjetore UAL) (Vizitë në Sekretarinë Mësimore)</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p>X</p>

<p><b>Standardi VI.4</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proçeset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>NJSBC ka në përbërje të saj nga një anëtar nga çdo fakultet i Universitetit Aldent, një ekspert të jashtëm dhe një përfaqësues të unionit studentor me një synim të përbashkët: përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>GVJ konfirmon mbështetur në të dhënat e raportit dhe vizitat në institucion që strukturat që shërbejnë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë kanë detyra të përcaktuara qartë në statut dhe aktet e tjera rregullatore të IAL. Në aktet rregullatore specifikohen qartë mënyra</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete</p>	



<p>për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>e krijimit të këtyre organeve, funksionet kryesore, vendimmarrja dhe njësitë e tjera me të cilat ato ndërveprojnë. GVJ konstaton që detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara për çdo njësi garantojnë ushtrimin me përgjegjësi të sigurimit të cilësisë. Në rregulloren e NJSBC janë të parashikuara detyrat e palëve të përfshira në çështjet e cilësisë.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në procedurat e vlerësimit të cilësisë marrin pjesë të gjithë aktorët, të cilët kanë një ndikim të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë në realizimin e programit të studimit. Njësia bazë, personeli akademik dhe administrativ, si dhe studentët, luajnë një rol të rëndësishëm bashkëpunues me strukturat e sigurimit të cilësisë në nivel institucional.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion u vu re se aktorët e aktivizuar në këtë proces vlerësimi janë të pavarur, të barabartë dhenë unison, për një proces sa më korrekt dhe me vetëbesim për punën dhe kapacitetet e veta. Edhe studentët shprehen pozitivisht dhe gëzojnë të drejtat e tyre, ashtu sic njohin edhe detyrimet akademike</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Në NJBSC bënte pjesë edhe një anëtar/ ekspert jashtëm. (Tabela 8, Tabelat)</p> <p>(Tabelat RVB Ba në TLD)</p> <p>(Rregullore e NJSBC)</p> <p>(Aprovimi NJSBC)</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p><b>Standardi VI.5</b>  <b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të</p>	

Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Njësia e brendshme e sigurimit të Cilësisë është angazhuar fortë në trajtimin dhe zgjidhjen e problemeve që paraqiten gjatë mësimdhënies apo auditimet e ndryshme në strukturë. Njësia e brendshme e sigurimit të cilësisë çdo fund viti akademik publikon raportin vjetor i cili i përcillet senatit akademik.			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Ky raport së bashku me planin e masave dorëzohet Rektorit dhe bëhet publik në faqen online të fakultetit duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Çdo student mund të aksesojë këtë raport.			
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Rezultatet e vlerësimit shoqërohen me një plan masash që i dorëzohet rektorit dhe ngrihen grupet e punës që caktojnë detyrat për të përmbushur gjatë vitit akademik dhesynojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	GVJ konstatoi se institucioni harton raportime lidhur me realizimin e plan masave në mënyrë periodike në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni në fillim të çdo viti akademik në javët orientuese, si dhe pas çdo Procesi të vlerësimit të jashtëm realizon seanca informimi më qëllim përmirësimin e vazhdueshëm, ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit <i>(Rregullore e NJSBC)</i> <i>(Formulari performancës akademike)</i> <i>(Analiza vjetore UAL)</i> <i>(Takimi me NJSBC)</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X



**Përfundime të vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Teknika Laboratorike Dentare” të Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti “Aldent”**

**Pikat e forta dhe afirmime:**


1. Programi i studimit ofrohet me veçorinë e zhvillimit të mësimin në një Universitet me orientim tërësisht në fushën e mjekësisë.
2. Plani mësimor i programit të studimit ka një numër të konsiderueshëm orësh laboratorike në protetikën parciale, totale dhe fikse gjë që lehtëson punësimin e shpejtë të studentëve pas diplomimit.
3. Caktimi i një tutori akademik për çdo kurs edhe në këtë program, rrit sigurinë e studentëve në përballimin me sukses të gjithë problematikës gjatë kohës së studimeve.
4. Mbështetje nga ana e IAL-së për personelin akademik të këtij programi studimi për trajnimin e tyre të vazhdueshëm profesional.
5. Infrastruktura efiçente në organizimin dhe zhvillimin e mësimdhënies veçanërisht asaj online gjatë periudhës së pandemisë;
6. Bashkëpunime me firma ndërkombëtare në funksion të këtij programi studimi në funksion të përdorimit të materialeve të reja dhe metodave inovative në fushën laboratorike dentare.
7. Studentët kryejnë punime për pacientë realë gjatë vitit të fundit të studimeve gjë që rrit shumë vetëbesimin tek ata.

**Pika të dobta:**

1. Numër i ulët i teksteve mësimore në gjuhën shqipe për këtë program studimi.
2. Mobiletet i pakët i studentëve për shkak të veçorive të këtij programi studimi.

**Rekomandime:**

1. Të shikohet mundësia e botimit të librave profesional në gjuhën shqipe nga institucioni.
2. Rekomandojmë që institucioni të shtojë në laboratorët e vet edhe pajisje bashkëkohore, si CAD-CAM apo skaner në funksion të laborantëve dentar.



**Conclusions of the evaluation of the study program of the first cycle Bachelor "Dental Laboratory Techniques" of the Institution of Higher Education "Aldent" University**

**Strengths and affirmations:**


1. The study program is offered with the feature of teaching development in a University with orientation entirely in the field of medicine.
2. The curriculum of the study program has a considerable number of laboratory hours in partial, total and fixed prosthetics, which facilitates the rapid employment of students after graduation.
3. Assigning an academic tutor for each course in this program, increases the confidence of students in successfully coping with all problems during their studies.
4. Support from the HEI for the academic staff of this study program in their continuous professional training.
5. Efficient infrastructure in the organization and development of teaching, especially online during the pandemic period.
6. Collaborations with international firms for this study program, in function of learning from students the use of new materials and innovative methods in the field of dental laboratory.
7. Students perform works for real patients during the last year of studies which greatly increases their self-confidence.

**Weak points:**

1. Reduced number of textbooks in Albanian language for this study program.
2. Reduced student mobility due to the features of this study program.

**Recommendations:**

1. Consider the possibility of publishing professional books in Albanian by the institution.
2. We recommend that the institution add to its laboratories modern equipments, such as CAD-CAM or scanners for dental laboratories.



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				<b>X</b>

